



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure



AGJENCIONI PËR  
MBROJTJEN E MJEDISIT  
TË KOSOVËS

KOSOVSKA  
AGENCIJA  
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO  
ENVIRONMENTAL  
PROTECTION AGENCY

# RAPORT GJENDJA E UJËRAVE NË KOSOVË 2020

# Raport për gjendjen e ujërave në Kosovë 2020



**PËRMBAJTJA**

<b>1. PJESA HYRËSE</b> .....	7
1.1. Hyrje.....	7
1.2. Karakteristika të përgjithshme për Kosovën .....	7
1.2.1.Hidrografia.....	7
1.2.2.Reshjet.....	7
1.2.3.Hidrogjeologjia.....	8
<b>2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE</b> .....	17
2.1. Korniza ligjore dhe strategjike.....	17
2.1.1.Ligjet, Udhëzimet Administrative dhe Vendimet në sektorin e ujërave..	17
2.1.2.Plani Strategjik i Kosovës për Ujera.....	19
2.1.3.Plani dhe Programet për Monitorimin e Ujërave.....	19
2.2. Direktivat e Bashkimit Evropian për Ujëra .....	20
2.3. Institucionet përgjegjëse .....	21
2.3.1. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit /Autoriteti Rregullativ i Pellgjeve Lumore të Kosovës .....	21
2.3.2. Këshilli Ndërmnistror për Ujërat.....	21
2.3.3. Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës / Instituti Hirdometerologjik i Kosovës.....	21
2.3.4. Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik.....	23
2.3.5. Pushteti Lokal- Komunitat .....	24
2.3.6. Autoriteti i Rajonal i Pellgjeve.....	24
2.3.7. Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit .....	25
2.3.8. Ndërmarrjet Publike/Kompanitë.....	25
2.3.9. Shërbimi Gjeologjik i Kosovës.....	27
2.3.10. Organizatat Joqeveritare.....	28
<b>3. MENAXHIMI I RESURSEVE UJORE</b> .....	29
3.1. Planifikimi dhe menaxhimi i ujërave .....	29
3.1.1. Sistemi informative i ujërave.....	29
3.1.2. Mbrojtja e ujërave.....	30
3.1.3. Zonat e mbrojtura ujore dhe sanitare.....	31

3.1.4. Zonat e ndjeshme (sensitive) ujore .....	33
3.1.5. Pellgjet dhe nënpellgjet ujore.....	33
3.1.6. Liqenet (liqenet artificial, liqenet natyrale).....	40
3.1.7. Ujërat nëntokësore.....	42
3.1.8. Ujërat termo-minerale.....	42
3.1.9. Ligatinat.....	44
4. <b>SHFRYTËZIMI I RESURSEVE UJORE PËR EKONOMI</b> .....	46
4.1. Shfrytëzimi i ujërave për pije dhe amvisëri .....	46
4.2. Shfrytëzimi i ujërave për ujitje .....	47
4.3. Shfrytëzimi i ujërave në industri .....	48
4.4. Shfrytëzimi i ujërave për hidroenergjetikë .....	50
4.5. Shfrytëzimi i ujërave për rekreacion .....	52
5. <b>MONITORIMI I UJËRAVE</b> .....	53
5.1. Monitorimi i ujërave sipërfaqësor .....	53
5.1.1. Pellgu i Drinit të Bardhë .....	55
5.1.2. Pellgu i Ibrit .....	57
5.1.3. Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit .....	58
5.2. Vlerësimi i gjëndjes dhe rezultatet e monitorimit .....	59
5.2.1. Pellgu i Drinit të Bardhë .....	59
5.2.2. Pellgu i Ibrit.....	65
5.2.3. Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit .....	70
5.3. Monitorimi i ujërave nëntokësor/Planit monitorues .....	76
5.4. Monitorimi i ujërave për pije .....	78
6. <b>UJËRAT E SHKARKUARA NDOTËSE DHE TRAJTIMI</b> .....	80
6.1. Ujërat e shkarkuara urbane .....	80
6.2. Ujërat e shkarkuara industriale.....	81
6.3. Trajtimi i ujërave urbane, industriale dhe agrokulturale.....	81
7. <b>RREGFULLIMI DHE KONTROLLIMI I UJËRAVE</b> .....	83
7.1. Paralajmrimet e hershëm për vërshimet .....	83
7.2. Thatësitrat .....	86

7.3. Zonat eruzive.....	88
7.4. Digat.....	88
7.5. Zonat e degraduara (vitet 2012-2018).....	90
<b>8. SHËRBIMET, INFRASTRUKTURA DHE INVESTIMET.....</b>	<b>92</b>
8.1. Tarifa për shfrytëzimin e ujërave /ujësjellës dhe kanalizim.....	92
8.2. Aktet ujore, pëqimet ujore, lejet ujore.....	93
8.3. I nfracstruktura, projektet dhe investimet në sektorin e ujërave.....	93
<b>9. REFERENCAT.....</b>	<b>98</b>
<b>10. MASAT DHE PARANDALIMI I NDOTJËS SË UJËRAVE.....</b>	<b>99</b>
<b>11. KONKLuzionet dhe Rekomandimet.....</b>	<b>101</b>
<b>12. INDEKSI I SHKURTESAVE.....</b>	<b>102</b>
<b>13. INDEKSI I TABELAVE.....</b>	<b>103</b>
<b>14. INDEKSI I FIGURAVE.....</b>	<b>104</b>

## **Sqarim**

Referimi i emërtimi të Ministrisë në Raport është përdorur sipas periudhës përkatëse të raportimit para hyrjes në fuqi të Rregullores (QRK) – Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive është miratuar në mbledhjen e 2-të të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr. 01/02, datë 26.03.2021.

## 1. PJESA HYRËSE

### 1.1. Hyrje

Raporti për gjendjen e ujërave në Kosovë paraqet gjendjen e ujërave për periudhën 2015-2019. Në raport janë të përfshirë gjëndja e ujërave sipërfaqësore, nëntokësore, Ligjet dhe UA për ujëra, dokumentet strategjike për ujëra, shpërndarja, rrjeti hidrografik, akumulacionet, shfrytëzimi për sektoret e ndryshme, investimet etj. Të dhënat për përgatitjen e raportit janë grumbulluar nga institucionet që bëjnë monitorimin e cilësisë së ujërave, kompanitë që menaxhojnë ujërat si dhe institucione tjera qeveritare dhe joqeveritare të cilat kanë përgjegjësi të caktuara në sektorin e ujërave. Të dhëna janë marrë edhe nga burime të ndryshme si publikime dhe referime nga burime të ndryshme. Në raport të dhënat janë të paraqitura në mënyrë tekstuale, tabelare, figurave të ndarë sipas fushave dhe sektorëve përkatës. Raporti është i ndarë në kapituj të cilat janë të paraqitura në përmbajtjen e tij. Në një kapitull të veçantë raporti nxjerr konkluzionet dhe jep rekomandimet për ndërmartjen e masave të duhura për përmirësimin e gjendjes.

### 1.2. Karakteristika të përgjithshme për Kosovë

Kosova ka një pozitë të përshtatshme gjeografike në Ballkanin. Ka një sipërfaqe prej 10908 km<sup>2</sup>. Gjatësia dhe gjrësia gjeografike paraqitet në shkallët 41° 51' 21"- 43° 16' dhe 19° 59' - 21° 47'. Ka një popullësi prej 1,771,604 banorë, me 38 komuna dhe 1469 vendbanime. Gjatësia e përgjithshme e kufirit është 743.5 km, e kufizuar më 4 shtete të rajonit. Relievi është kodrinor malor me një lartësi mesatare mbidetare 810 m (pika më e ulët 270 m dhe më e lartë 2656 m).

Në Kosovë mbretërojnë dy klima; e mesme kontinentale (Rrafshi i Kosovës) dhe me ndikim Adriatik (Rrafshi i Dukagjinit).

#### 1.2.1. Hidrografia

Hidrografia e Kosovës paraqet një pasuri natyrore që përfshin ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Në varësi prej përbërjes gjeologjike të tokës dhe strukturës gjeografike varet edhe shpërndarja natyrore e rrjetit hidrografik. Kosova ka një rrjet të larmishëm të lumënjëve të mëdhenj dhe të vegjël, akumulacione ujore artificiale dhe natyrore. Në përgjithësi resurset ujore në vend kanë një shpërndarje gjeografike jo të barabartë prej një rajoni në tjetrin. Rrafshi i Dukagjinit sipas studimeve të ndryshme është më i pasur me resurse ujore në krahasim më regjionet tjera të Kosovës.

#### 1.2.2. Reshjet

Të reshurat atmosferike variojnë prej vitit në vit. Për periudhën 2015-2019, si vit me të reshura më të larta në nivel vendi janë regjistruar në vitin 2016 dhe 2018, ndërsa prej regjioneve me të reshura më të mëdha atmosferike janë matur në regjionin e Dukagjinit (Juniku), Tab.1.



Tabela 1. Sasia totale e reshjeve për periudhën 2015-2020

Sasia totale e reshjeve (mm ose L/m <sup>2</sup> )ne baza vjetore, periudha 2015-2019						
Nr.	Data/stacioni	2015	2016	2017	2018	2019
1	Mitrovicë	-	759.2	657.6	535.7	554.9
2	Pejë	844.6	972.5	758.2	999.8	901.8
3	Prishtinë	659.5	890.0	703.5	667.5	607.4
4	Prizren-Automatik	599.1	720.8	621.5	566.4	413.3
5	Ferizaj	672.6	834.8	752.8	980.3	572.7
6	Junik	1076.7	1417.5	1137.4	1265.3	1023.4
7	Gjak.-Radoniq	496.7	1020.2	723.6	985.5	912.5
8	Gjak.-Rakovinë	469.2	897.0	731.8	750.8	573.5
9	Gjilan - Verbica e Zhegovcit	738.2	984.8	629.4	767.2	701.0
10	Gjil-Bilinicë	721.5	724.8	681.8	680.2	448.8
11	Gjil.-Prelepnice	679.3	817.9	572.6	577.4	494.3
12	Kam.- Desivojcë	856.6	917.3	776.6	788.6	626.9
13	Kam.-Rogoqic	666.9	757.9	612.9	608.2	521.0
14	Leposaviq	-	-	-	590.2	701.7
15	Lipjan	-	812.3	608.9	673.7	530.2
16	Novoberd	634.7	832.0	629.4	543.0	485.1
17	Pejë-Ramun	673.1	978.2	698.7	911.0	825.5
18	Pod.-Shajkovc	704.0	575.4	472.7	746.3	601.5
19	Pod.-Batllavë	-	575.3	601.6	555.6	390.1
20	Pod.Zakut	628.7	813.0	723.6	630.4	511.1
21	Priz.-Gryka Prizrenit	-	683.4	885.5	855.0	756.1
22	Suharekë	-	826.2	707.6	885.7	635.7
23	Suh.Budakovë	621.7	944	862.8	858.4	700.4
25	Mali-Kijevë	663.8	811.8	640.9	695.5	547
26	Malishevë	710.5	898.8	710.2	609.3	709.4

**Shënim:**

Stacioni automatik në Prizren - Mungojnë të dhënat për muajt 11-12/2018 dhe 01-02-03-04-05/2019;

Stacioni në Gjakovë /Radoniq - Mungojnë të dhënat për muajt 07-08-09-10-11-12/2015;

Stacioni në Shajkovc - Mungojnë të dhënat për muajt 09-10-11-12/2016 dhe 01-02-03-04/2017.

**1.2.3. Hidrogeologjia**

Në aspektin hidrogeologjik territori i Kosovës është relativisht e pasur me ujërat sipërfaqësorë (liqejtë, lumenjtë, proçkat etj), dhe ujëra nëntokësor, ujëra termale dhe termominerale. Mirëpo nisur nga fakti hidrogeologjik, ujërat në Kosovë ende janë enigmë dhe të pa studiuar nga aspekti i sasisë apo ndonjë bilanc të ujërave. Ndërsa ajo që dihet lidhur me ujërat e Kosovës është cilësia e tyre.

## Gjeologjia dhe hidrogjeologjia e pellgut lumor “Drini i Bardhë”

Në aspektin gjeologjik, pellgun lumor “Drini i Bardhë” e ndërtojnë formacionët gjeologjike të moshave të ndryshme si:

- Formacionët e Paleozoikut (Pz), Formacionët e Triasikut (T), Formacionët e Jurasikut (J), Formacionët e Kretakut (K), Formacionët e Miocenit (M), Formacionët e Pliocenit (Pl), Kuaternarit (Q), shih Figurën 1.




Figura 1. Harta gjeologjike e pellgut Drini i Bardhë

Bazuar në formacionët gjeologjike dhe veçorive litologjike, strukturore e tektonike, në pellgun lumor “Drini i Bardhë” janë dalluar tri tipe kryesore akuiferësh:

- Akuifer aluvial të Kuaternarit;
- Akuifer të Miocenit dhe Pliocenit; si dhe
- Akuifer Karbonatik (shih Figurën. 2).




Figura 2. Harta hidrogeologjike e pellgut Drini i Bardhë

### Gjeologjia dhe hidrogeologjia e pellgut lumor Ibër-Sitnicë

Pellgu lumor Ibër-Sitnicë në aspektin gjeologjik e ndërtojnë formacionët të ndryshme gjeologjike (fig. 3).

Pellgu lumor Ibër-Sitnica e ndërtojnë këto formacionë të shkëmbinjeve:

- Formacionët e serisë së Trepçës (ranore, rreshpe kuarcore me shkallë të ulët të metamorfizmit, kongllomera të kuarci dhe gëlqeror);
- Formacionë të shkëmbinjeve ultrabazik dhe bazik (serpentin, amfibol, diabaz, gabro);
- Krijime (Sedimente) të Terciarit (kongllomere dhe ranorë, tufe, andezite piroksenite);
- Kontakti i dyshemesë së Terciarit të shkëmbinjeve vullkanogjen me gëlqeror, serpentinite; gabro, amfibolit, etj. Ky kontakt paraqitet në qarjet apo rrudhat (El 376 - 1989);
- Kontakti i gëlqerorëve me rreshpe, (El- 376, 1989);
- Krijime (Sedimente) të Jurasiku (serpentin, gabroamfibolit, brekçie dhe gëlqeror); dhe

- Sedimentet liqenore-lumore (të cilat shtrihen për gjatë luginave dhe shtretërve të lumenjëve).




Figura 3. Harta gjeologjike e pellgut lumor Ibër-Sitnica

Karakteristikat hidrogjeologjike të Pellgut lumor Ibër-Sitnicë është i njohur me resurse të pasura ujore. Pellgun e përshkohnë katër lumenjë: Ibëri, Sitnicë, Lushta dhe Trepça. Në këtë pellg lumor gjendet edhe liqeni artificial i Ujëmanit me kapacitet 395 milionë m<sup>3</sup> dhe burime të tjera ujore të cilat gjinden në regjionin e Shalës së Bajgores.

Pellgu ujëmbledhës i lumit Ibër me degët e tij Sitnica, Lushta, Trepça dhe Bistrica, ka një sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës prej 4.035 km<sup>2</sup>. Gjatësia e Ibrit në territorin e Kosovës është vetëm 42 km (vetëm 15 km në territorin e komunës) dhe me prurje mesatare prej 32,6 m<sup>3</sup>/sec.

Sasia mesatare vjetore e ujit në pellgun e ujëmbledhësit të lumit të Ibërit është 1.146,33 milionë m<sup>3</sup>. Thellësia e ujit është e ndryshme për arsye se “Ibri” e ka formuar shtratin e vet në shtresa të ndryshme gjeologjike (fig. 4). Në zonën kodrinore, me qëllim të përmirësimit të regjimit të rrjedhjes së lumit “Ibër” dhe shfrytëzimit racional dhe shumë funksional të ujërave është ndërtuar diga, duke krijuar Liqenin i Ujmanit (Gazivodës), vëllimi i ujit të të cilit është 390.000.000 m<sup>3</sup>. Uji nga ky rezervuar përdoret për pije, industri, për ujitje dhe prodhim të energjisë elektrike.




Figura 4. Harta hidrogjeologjike e pellgut lumor Ibër-Sitnicë

### Gjeologjia dhe hidrogjeologjia e pellgut lumor Morava e Binçës

Pellgut lumor Morava e Binçës veçohet me formacionë të rejtatë Kenozoikut. Dominojnë sendimetet e konglomeratit, të zallit dhe rërës së moshës së nëogjenit, duke e bërë këtë hapësirë më homogjenë në aspektin litologjik (shih Figuren 5).




Figura 5. Harta gjeologjike e pellgut lumor Morava e Binçës

Karakteristikat hidrogjeologjike të pellgut Morava e Binçës - rëndësi më të madhe në aspektin hidrogjeologjik kanë sedimentet e reja, sidomos ato të neogjenit dhe kuaternarit. Shkëmbinj të e kësaj moshe karakterizohen nga rërat, zhavorret dhe argjilat, të cilat luajnë rolin e kolektorëve të ujërave nëntokësore (shih Figurën 6).

Nëpër Fushën e Anamoravës rrjedh lumi Morava e Binçës me degët e veta si lumi i Karadakut, Llapushës, Livoqit, Stanishorit , Përlepnicës dhe Krivarekës.




Figura 6. Harta gjeologjike e pellgut Morava e Binçës

### Gjeologjia dhe hidrogjeologjia e pellgut lumor Lepenc

Pellgu lumor Lepenc në aspektin gjeologjik është i ndërtuar nga njësitë e ndryshme litostratigrafike. Seria më e vjetër është Paleozoiku – rëshpet biotite, gnëjset, mermerët dhe amfibolitët. Ndërmjet tyre shtrihen formacionët diabaze – strallore argjilore, ranore dhe ultrabazikët. Në depozitimet e Jurasikut hyjnë shtresat gëlqerore të Kretakut të Sipërm dhe fliшет. Depozitimet sedimentare i përkasin Neogjenit.

Në luginën e lumit Lepenc ka depozitime të aluvionit, në pjesën jugore të pellgut shfaqen thjerrëzat e bigarit (çmërs nga Kalciumi dhe Magnëzi) (Shih Figurën 7).

Pellgun lumor Lepenc e ndërtojnë këto produkte gjeologjike: Produktet Paleozoike (Pz), Depozitimet e Jurasikut (J), Depozitimet e Kretakut (CR<sup>2</sup><sub>3</sub>), Depozitimet e Plicenit (N2), Depozitimet e Kuaternarit (Q1), Sedimentet aluviale, Sedimentet Lumore.




Figura 7. Harta gjeologjike e pellgut lumor Lepenc



Karakteristikat hidrogeologjike të pellgut lumor Lepenc- nështë shumë i pasur me ujëra sipërfaqësore dhe ujëra nëntokësore. Në pellgun lumor Lepenc i takojmë pothuajse të gjithë akuifer të cilët i kemi klasifikuar në katër kategori: (Shih Figurën.8)

- Akuifer inTërgranular me porozitet shumë të lartë;
- Akuifer inTërgranular me porozitet të mesëm;
- Akuifer çarës – karstik të fortë; dhe
- Akuifer (shkëmbinjë) karstik shumë të fortë.




Figura 8. Harta hidrogeologjike e pellgut lumor Lepenc

## 2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE

Republika e Kosovës i është çasur afrimit të standardeve mjedisore të BE-së dhe është bërë përparim substancial në zhvillimin e legjislacionit që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi duke përfshirë edhe mbrojtjen e ujërave.

Pajtueshmëria e legjislacionit të Kosovës me *acquis* të BE-së vlerësohet përmes monitorimit të progresit të transpozimit dhe implementimit të legjislacionit. Një numër i konsideruar i ligjeve të mjedisit janë rishikuar dhe adaptuar në vitet e fundit nga Kuvendi i Kosovës. MEA ka bërë progres të dukshëm edhe në adaptimin e legjislacionit sekondar (udhëzimet administrative, rregulloret, vendimet etj). Po ashtu ka aprovuar edhe Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë, që do të ndikoi në zhvillimit të resurseve ujore.

### 2.1. Korniza ligjore dhe strategjike

Gjatë ketyre viteve MEA ka hartuar një mori ligjesh, udhëzimesh dhe strategjinë për ujrën. Ligjet, UA dhe vendimet në sektorin e ujërave kanë bazë ligjore e cila rregullon sektorin për menaxhimin e ujërave në Kosovë përbëhet nga legjislacioni primar dhe sekondar.

#### 2.1.1. Legjislacioni primar përbëhet nga këto ligje bazike:

Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës - Qëllimi i këtij ligji është:

- Të siguroj zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin shoqëroro-ekonomik të Kosovës;
- Të themelojë procedurat dhe parimet udhëzuese për shpërndarjen optimale të resurseve ujore, mbështetur në shfrytëzim dhe qëllim;
- Të siguroj mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, mbi-shfrytëzimi dhe keqpërdorimi
- dhe
- Të përcaktoj kornizën institucionale për administrimin e resurseve ujore.

Ligji Nr. 02 /L-79 për Veprimtarinë Hidrometeorologjike - Është një ligj tjetër i rëndësishëm në sektorin e ujërave qëllimi i së cilit është të rregulloj punët hidrometeorologjike dhe mënyrën e kryerjes së tyre.

Ligji Nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike- Ky ligj pos tjerash përcakton Institucionet përgjegjëse për zbatimin e politikave të shëndetësisë, përcakton detyrat e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës ku në mes tjerash përcaktohen edhe detyrat për monitorimin e kualitetit të ujit të pijes.

Ligjit Nr. 03/L-086 për Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit, Kanalizimit dhe Mbeturave- është një Ligj i rëndësishëm përmes të cilit është themeluar Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) dhe është krijuar korniza ligjore për rregullimin ekonomik të kompanive publike të cilat ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Ligji Nr. 02/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore- Ky Ligj rregullon organizimin dhe administrimin e ujitjes dhe kullimit të tokës bujqësore në Kosovë, kompetencat dhe ndarjen e përgjegjësisë të subjekteve të ujitjes dhe kullimit, formimin dhe regjistrimin e kompanive

të ujitjes, shoqatave të përdoruesve të ujit për ujitje, federatave, organizimin e tyre, tarifave të ujit për ujitje, afarizmin e shoqatave dhe çështje të tjera lidhur me ujitjen dhe kullimin.

### **Legjislacioni sekondar**

Në kuadër të obligimeve që dalin nga Ligji për Ujëra dhe Ligji për Shëndetin Publik janë hartuar dhe nënshkruar këto udhëzime administrative:

- Udhëzimi Administrativ Nr.30/2014 për “Kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik në trupin ujqor”;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 26/2013 për “Përcaktimin e mënyrës së evidentimit dhe formën legjitimacionit të inspektoratit për ujëra”;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2013 për “Sistemin informativ ujqor”;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2012 për “Cilësinë e ujit që përdoret për qëllime të konsumit nga njerëzit”;
- Udhëzimi Administrativ Nr.28/2013 për “Zonat e Mbrojtura Sanitare”;
- Udhëzimi Administrativ Nr.19/2015 për “Mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave”;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2016 për “Strukturën e pagesave të ujit”;
- Udhëzim Administrativ Nr.16/2017 “Klasifikimi i trupave ujqorë sipërfaqësorë”;
- Udhëzim Administrativ Nr. 17/2017 “Klasifikimin e trupave ujqorë nëntokësor”;
- Udhëzim Administrativ Nr. 15/2017 “Kriteret për përcaktimin e zonave të mbrojtura sanitare të burimit të ujit”;
- Udhëzim Administrativ për Nr. 11/2016 “Për përcaktimin, mënyrën dhe procedurat për mbrojtjen e zonave erozive”
- Udhëzimi Administrativ për Nr. 04/2016 “Kushtet Kriteret dhe procedurat për Mbrojtjen e Brigjeve të Ujërrjedhave dhe Akumulimeve”;
- Rregullore Nr. 02/2016 për “Mënyrën e përcaktimit të prurjes së pranueshme ekologjike”
- Udhëzim Administrativ Nr. 05/2016 për “Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujqore”;
- Udhëzim Administrativ Nr. 20/2015 për “Caktimin për zonat për larje”;
- Udhëzim Administrativ Nr. 09/2016 për “Strukturën organizative dhe detyrat shpesh të Autoritetin e Rajonit të Pëllgjeve Lumore”;
- Udhëzim Administrativ Nr. 05/2016 për “Rregullimin e statusit të pasurisë ujqore”;
- Udhëzimi Administrativ Nr.09/2017 për “Projektimin, Ndërtimin dhe Shfrytëzimin e Digave”;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2018 për “Procedurat për Leje Ujqore”;

### 2.1.2. Strategjit e Ujërave të Kosovës 2017-2036

Është një nga dokumentet kryesore të planifikimit të resurseve ujore në Republikën e Kosovës. Ky dokument është detyrim ligjor në përputhje me Ligjin Nr.04/L-147, Neni 31. Qeveria synon që përmes këtij dokumenti të adresoj dhe orientoj zhvillimet politike, operative dhe investive në sektorin e ujërave për periudhën 20 vjeçare. Qëllimi i Strategjisë është që të ofrojë një zhvillim të integruar dhe të qëndrueshëm të sektorit të ujërave duke përbushur nevojat vijuese:

- Furnizimit me ujë të pijshëm;
- Ujë për prodhimin e ushqimit;
- Ujë për ujitjen e tokave bujqësore;
- Ujë për industrinë;
- Sport dhe rekreacion; dhe
- Gjenerimin e energjisë elektrike.

### 2.1.3. Plani dhe programet për monitorimin e ujërat

Programi i Monitorimit të ujërave hartohet nga Ministria ndërsa miratohet nga Qeveria. Programi i monitorimit hartohet për një periudhë dyzet (40) vjeçare me mundësi rishikimi, plotësimi dhe ndryshimi, bazuar në të dhënat e monitorimit <sup>1</sup>. Kompetent për zbatimin e monitorimit është IHMK.

Programi për Monitorimin e Ujërave Sipërfaqësor dhe Nëntokësor në territorin e Republikës së Kosovës ka për qëllim:

- Monitorimin sistematik dhe koherent të cilësisë së ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësorë;
- Përmabajtja e detyrimeve sipas ligjeve vendore në harmoni me DKU 2000/60 EC dhe direktivat për ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësor të BE-së;
- Mbeshtetjen e procedurave të vendimmarrjes;
- Ofrimi i të dhënave të besueshme lidhur me cilësinë e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor.

Programi i monitorimit të ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësor përmban:

- Vendodhjen e vend-mostrës me koordinatat;
- Numrin e frekuencave të mostrës;
- Parametrat fiziko kimik, metalet e rënda dhe pesticidet si dhe elementet biologjike të paraqitura në formë tabelare;
- Parametrat radioaktiv në ujë;
- Pasqyrimi në hartë të pikave monitoruese; dhe
- Koston dhe analizën financiare të implementimit <sup>2</sup>.

<sup>2</sup> Programi i Monitorimit të Ujërave Siperfaqësor dhe Nëntokësor 2014-2015, MMPH, datë: 26.03.2014, Nr. SP1451/14.

## 2.2. Direktivat e Bashkimit Evropian për Ujëra

Lista e direktivave nga udhëzuesi i pyetësorit, Anexi 34\_Acquis, ch 27: Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike, nga monitorimi i Komisioni Evropian për Raportin Vjetor të Kosovën.

Direktiva e Këshillit Nr. 91/676/EEC e 12.12.1991 “që ka të bëjë me mbrojtjen e ujërave nga ndotja të shkaktuar nga nitratat nga burimet bujqësore”, të amendamentuar nga rregulloret Nr. EC/1882/2003 dhe EC/1137/2008.

Direktiva e Këshillit Nr. 91/271/EEC e 21.05.1991 që ka të bëjë me “trajtimin e ujërave të ndotura” e amendamentuar nga Direktiva Nr. 98/15/EC dhe Rregulloret EC/1882/2003 dhe EC/1137/2008.

Direktiva e Këshillit Nr. 98/83/EC e 03.11.1998 “për cilësinë e ujit që përdoret për qëllime të konsumit nga njerëzit”, e amendamentuar nga Rregulloret Nr. EC/1882/2003 dhe EC/596/2009

Direktiva Nr. 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23.10.2000 “themelimin e një kornize për veprim të Komunitetit në fushën e politikës së ujit”, e amendamentuar nga Vendimi Nr. 2455/2001/EC dhe Direktivat Nr. 2008/32/EC, 2008/105/EC dhe 2009/31/EC

Direktiva Nr. 2009/90/EC e 31 Korrikut 2009 që përcakton, sipas Direktivës 2000/60/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, për specifikimin teknik të analizave kimike dhe monitorimi i statusit të ujit (Tekst me relevancë për EEA).

Direktiva Nr. 2006/7/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15.02.2006 “që ka të bëjë me menaxhimin e ujërave për larje” dhe zëvendësimin e Direktivës Nr. 76/160/EEC, e amendamentuar nga Rregullorja Nr. EC/596/2009.

Direktiva Nr. 2006/11/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15.02.2006 “për ndotjet e shkaktuara nga disa substanca të rrezikshme në mjedise ujore” e Komunitetit, zëvendësuar nga 76/464/EEC, versioni i kodifikuar për t’u zëvendësuar me 22.12.2013 me Direktivën 2000/60/EC.

Direktiva Nr. 2006/118/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 12.12.2006 “për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe shkatërrimi”.

Direktiva Nr. 2007/60/EC e 23 Tetor 2007 për vlerësimin e menaxhimit të rrezikut nga vërshimet (Teksti me relevancë të EEA).

Direktiva Nr. 2008/105/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16.12.2008 “standartet e cilësisë në lëmin e politikave të ujit, ndryshuar me direktivën 2013/39/BE, “për ndryshimin e Direktivave 2000/60/EC, dhe 2008/105/EC për Substanca prioritare në lëmin e politikave të ujit”.

Directivca 98/83/EC për Ujërat e Pijes.

Directive 91/676/EEC Nitratat.

### 2.3. Institucionet përgjegjëse

Ekzistojnë një numër i institucioneve të nivelit qendror dhe lokal si dhe ndërmarrje publike të cilat merren me mbrojtjen dhe menaxhimin e ujërave.

**2.3.1. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit / Autoriteti Rregullativ i Pellgjeve Lumore të Kosovës** konform Ligjit Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës është përgjegjëse për:

- Hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore, strategjive, planeve dhe politikave që kanë të bëjnë me të gjitha çështjet e resurseve ujore në Republikën e Kosovës;
- Zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore nga fusha e resurseve ujore, përfshirë edhe ligjet tjera nga fusha e mjedisit jetësor;
- Administrimin dhe menaxhimin e të gjitha resurset ujore në territorin e Republikës së Kosovës;
- Kryerjen e të gjitha punëve dhe aktiviteteve administrative, profesionale dhe punëve tjera organizative dhe zhvillimore që obligohen me këtë ligj;
- Bashkëpunimin e ngushtë me ministrinë tjera të linjës në Republikën e Kosovës lidhur me resurset ujore dhe mjedisin jetësor; dhe
- Bashkëpunimin ndërkufitar me shtetet fqinje dhe më gjërë në fushën e resurseve ujore.

**2.3.2. Këshilli Ndërmnistror për Ujërat** është trup koordinues dhe vendimmarrës, që shqyrton çështjet sistemore të administrimit me ujëra, harmonizimin e nevojave dhe interesave të ndryshme, si dhe propozon masat për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e resurseve dhe sistemit ujor të Kosovës.

- Jep mendimeve dhe rekomandimeve për çështjen e ujërave në vend;
- Propozim ligjet dhe aktet tjera nënligjore që kanë të bëjnë me rregullimin e çështjeve nga fusha e ujërave në përgjithësi;
- Zbatimin e ligjeve dhe aktet nënligjore që kanë të bëjnë me menaxhimin e ujërave;
- Hartimin dhe aprovimin e Strategjisë Shtetrore për ujëra;
- Zhvillimin e politikave nga fusha e ujërave;
- Zgjedhjen e politikave financiare nga fusha e ujërave.

**2.3.3. Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës është themeluar nga Ministria, ku konform Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit ka përgjegjësi:**

- ✓ Të siguroj informacionin e duhur për administratën, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës për zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit;
- ✓ Të zhvilloj dhe koordinoj sistemin unik të informimit për mbrojtjen e mjedisit
- ✓ Ti vendosë dhe ti mbajë qendrat referente me bazat e të dhënave për përcjelljen e mjedisit (të dhënat socio-ekonomike, presionet në mjedis, gjendjen dhe kualitetin e mjedisit);
- ✓ Të zhvillojë procedurat për përpunimin e të dhënave të grumbulluara për mjedisin dhe

- ✓ vlerësimin e tyre (modelimin, prezantimin dhe paraqitjen vizuale);
- ✓ Të kryej punët profesionale gjatë përcaktimit të përmbajtjes, metodologjisë dhe mënyrës së përcjelljes të gjendjes së mjedisit.
- ✓ Të avancojë dhe krahasojë cilësinë e të dhënave për mjedisin;
- ✓ Të hartojë raporte për gjendjen e përgjithshme të mjedisit në Kosovë, synimeve, si dhe të raportojë për sektorët kryesor (ajrin, tokën, ujin, llojlojshmërinë biologjike, ndryshimet klimatologjike);
- ✓ Të hartojë raporte për çështjet e caktuar për mbrojtjen e mjedisit siç janë rajonet me radioaktivitet të shtuar, cilësia e mjedisit, shëndeti dhe ngjashëm;
- ✓ Kryen punë këshillë dhënëse për përcaktimin, mbajtjen dhe përcjelljen e projekteve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit;
- ✓ Të ndihmojë organet e administratës në zhvillimin e formave të reja të politikës për mbrojtjen e mjedisit dhe përcjelljen e zbatimit të planeve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit;
- ✓ Të bashkëpunojë me Agjencinë Evropiane të Mjedisit - AEM e cila është në përbërje të Rrjetit Evropian për Informim dhe Vëzhgim – RREIV;
- ✓ Të bashkëpunojë me institucionet dhe organizmat tjerë ndërkombëtar për mbrojtjen e mjedisit ;
- ✓ Të sigurojë qasjen në të gjitha informacionet për mjedisin e Kosovës sipas standardeve të AEM.
- ✓ Shfrytëzimi dhe këmbimi ndërshtetëror i të dhënave për mjedis do të rregullohet me ligj të veçant.

**Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës bazuar në Ligjin për Ujërat e Kosovës** ka përgjegjësi zbatimin e Programit të monitorimit i cili hartohet nga Ministria dhe miratohet nga Qeveria për një periudhë dyzet (40) vjeçare me mundësi rishikimi, plotësimi dhe ndryshimi, bazuar në të dhënat e monitorimit.

Gjithashtu, ky institut është përgjegjës për monitorimi e sasisë dhe cilësisë së ujërave sipërfaqësorë, nëntokësor dhe akumulacione.

Kurse , sa i përket përgjegjësive në ligjin bazik, gjegjësisht Ligjin për Veprimtaritë Hidrometeorologjike, ky institucion ka përgjegjësi:

- ✓ Planifikimin, ndërtimin, pajisjen, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemeve apo rrjeteve shtetërore të stacioneve meteorologjike, hidrologjike, cilësisë së ajrit dhe ujërave;
- ✓ Matjet dhe vrojtimit sistematike të elementeve dhe dukurive hidrologjike, meteorologjike, përmes sistemit të rrjetit shtetërorë hidrologjik dhe meteorologjik përfshirë dhe sistemin e vrojtimit radarike, sistemet e monitorimit të ajrit, ujit dhe dheut;
- ✓ Zhvillimin, vendosjen dhe funksionimin e sistemeve kompjuterike dhe telekomunikacionit për mbledhjen, përpunimin, shkëmbimin dhe shpërndarjen e të dhënave dhe informacionit për motin real dhe të parashikuar, për klimën dhe

- hidrologjinë si dhe të dhënat për cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës;
- ✓ Zhvillimin dhe përditësimin e arkivës së të dhënave meteorologjike dhe hidrologjike, duke përfshirë dhe cilësinë e ajrit dhe ujit, nga grumbullimi, kontrolli (validimi) përpunimi, publikimi dhe arkivimi i të dhënave;
  - ✓ Mbështetja me paralajmërimet dhe raportimet tek institucionet kompetente qendrore dhe lokale në rastet e paraqitjes së fatkeqësive meteorologjike dhe hidrologjike me rëndësi për mbrojtjen nga vërshimet dhe përmbytjet, fenomenit të akullit dhe fatkeqësive dhe katastrofave tjera meteo dhe hidrologjike, ndryshimet e cilësisë së ajrit, ujërave dhe tokës lidhur me avaritë dhe ndotjet e tjera të paraqitura;
  - ✓ Monitorimi dhe analiza e ndryshimit të gjendjes së motit, klimës, burimeve ujore dhe regjimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, rrezatimit diellor, energjisë potenciale të diellit, erës dhe ujit;
  - ✓ Zhvillimin dhe përdorimin e modeleve të ndryshme për parashikimin e motit, ndryshimit të klimës, depozitimit dhe shpërndarjes (transportit) së ndotësve në atmosferë përfshirë ndotësit në ajër, ujë dhe tokë;
  - ✓ Testimi dhe kalibrimi i instrumenteve matëse që përdoren në fushën e meteorologjisë, hidrologjisë, monitorimit të ajrit dhe instrumenteve laboratorike në konformitet me legjislacionin vendor dhe atë ndërkombëtarë;
  - ✓ Zhvillimi i sistemit meteorologjik ne parandalimin (luftimin) e breshrit dhe mënyrat e tjera të modifikimeve (veprimeve artificiale) të motit si dhe studimi i metodave të veprimeve artificiale mbi motin dhe klimën;
  - ✓ Aktivitetet ndërkufitare hidrometeorologjike dhe rreth cilësisë së ajrit dhe ujit për qëllime të menaxhimit të ujit dhe mjedisit bazuar në kërkesat e institucioneve përgjegjëse;
  - ✓ Trajnimin e stafit dhe zhvillimin profesional në fushën e aktiviteteve meteorologjike dhe hidrologjike, sipas kritereve të përshkruara nga Organizata Botërore e Meteorologjisë;
  - ✓ Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e meteorologjisë dhe hidrologjisë duke forcuar standardet dhe parimet e konventave ndërkombëtare në fushën e hidrometeorologjisë, monitorimit dhe hulumtimit për ndryshimet klimatike dhe cilësisë së ajrit, ujit dhe të tokës;
  - ✓ Punët e tjera hidrometeorologjike për të cilat janë përcaktuar me ligj se janë me interes për Kosovën. Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) duhet të përfaqësojë shtetin në fushën e meteorologjisë dhe hidrologjisë, dhe duhet të kryej funksionet e institucionit shtetëror hidrometeorologjik në organizata ndërkombëtare të meteorologjisë dhe hidrologjisë.

**2.3.4. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike** konform Ligjit për Ujërat e Kosovës është institucion përgjegjës për monitorimin e sasisë dhe cilësisë së ujërave që përdoren për pije dhe ofruesit e shërbimit të ujit.

Përndryshe, është Institucion Shëndetësor në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisëqë Përgatit dhe zbaton strategjinë e shëndetit publik (Masat higjieniko – sanitare, masat profilaktiko – kunderepidemike, socialo mjekësore, promovimin e shëndetit, edukimin



dhe arsimimin shëndetësor, kontrollën e kullitetit të ujit, ajrit, ushqimit, PZI (programi i zgjëruar i imunizimit), politikën shëndetësore dhe ekonomiken shëndetësore, informimin shëndetësorë) në mbarë territorin e Kosovës.

### 2.3.5. Pushteti lokal- Komunat është përgjegjëse për:

- ✓ Lëshimin e lejeve ujore të përcaktuar sipas aktit nënligjor për leje ujore.
- ✓ Komuna ka kompetencë edhe për mbrojtje nga veprimet e dëmshme të ujërave dhe mbrojtjen nga erozioni dhe veprimet tjera të dëmshme në zona urbane, zona e kufijve të qytetit
- ✓ Harton Programin për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave.
- ✓ Ka kompetencë për mbrojtjen e shtretërve, brigjeve të ujë rrjedhave, kanaleve, tuneleve dhe akumulimeve ujore brenda zonave urbane.
- ✓ Komuna dhe Autoriteti përcaktojnë masat dhe punët për mbrojtjen e zonave erozive dhe rregullimin e rrëkeve në bazë të dokumentacionit teknik dhe në përputhje me planet për menaxhimin e pellgjeve lumore.
- ✓ Financimi për mirëmbajtjen dhe rregullimin e rrekëve dhe aktiviteteve për mbrojtje nga erozioni kryhet nga Ministria, komuna dhe Autoriteti.
- ✓ Me objektet për rregullimin e rrëkesë menaxhon komuna në zonat urbane dhe Autoriteti.
- ✓ Komunat dhe Autoriteti janë të detyruara t'i ndër marrin të gjitha masat për rregullimin e rrëkeve në zonat urbane dhe pellgjet lumore.
- ✓ Komunat dhe Autoriteti janë të detyruara ta njoftojnë Ministrinë në afat sa më të shkurtër kohor me rastin e rrezikut nga erozioni dhe rrëketë.
- ✓ Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e shëndetësisë, Komunat dhe Kompanitë e ofrimit të shërbimeve të ujit, me akt nënligjor cakton zonat për larje.

### 2.3.6. Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore

Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore është autoriteti i themeluar dhe raporton në Ministri, i cili ka për qëllim administrimin e ujërave sipas Ligjit për Ujërat e Kosovës, në territorin e pellgjeve të caktuara, me që Kosova trajtohet si një rajon i pellgjeve lumore.

Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore ka përgjegjësi të:

- ✓ Mbledh të dhënat e nevojshme për caktimin e burimeve, sasi të dhe vetitë e ujërave;
- ✓ Ndërmerr masa të nevojshme për ruajtjen e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor; Përpilon vlerësime për secilin pellg;
- ✓ Siguron menaxhimin me pjesët e pellgut ndërkombëtar, në territorin e Kosovës;
- ✓ Udhëheq dhe mirëmban regjistrin e zonave të mbrojtura ujore;
- ✓ Harton planet për menaxhimin e ujërave për pellgun;
- ✓ Përpilon dhe zbaton programin e monitorimit dhe masave;
- ✓ Përkujdeset për zbatimin e masave për mbrojtje nga efektet e dëmshme të ujërave në pellg;
- ✓ Mbledh, përpunon dhe përkujdeset për të dhënat për vrojtimin e ujërave; Mbledh dhe përpunon të dhënat për regjistrin e objekteve dhe pajisjeve ujore; Themelon, përgatit dhe përkujdeset për regjistrin e ndotësve në pellg; Propozon shpronësimin e tokës në

- të cilën gjenden ujërat nëntokësorë, të nevojshme për furnizim publik;
- ✓ Mbledh mjete financiare nga kompensimet, kontributet, buxheti, grantet;
- ✓ Kryen punët financiare-administrative në pellgun përkatës;
- ✓ Afirmon metodat teknike për ruajtjen e ujërave; dhe
- ✓ Kryen detyra shtesë, të caktuara me akt nënligjor nga Ministria.

**2.3.7. Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit** është autoritet i pavarur, është përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimit të ujit Kosovë.

Roli i ARRU është që të siguroj ofrimin e shërbimeve cilësore, efçente, dhe të sigurta në baza jo-diskriminuese për tërë konsumatorët në Kosovë, duke pasur parasysh mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik.

Konform Ligjit Nr. 05/L -042 I përgjigjet Kuvendit të Kosovës ka përgjegjësi:

- ✓ Licencimin e ofruesve të shërbimeve dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kushteve të përcaktuara me licencë të shërbimit;
- ✓ Përcaktimin e tarifave të shërbimit për ofruesit e shërbimeve, duke siguruar që tarifat të jenë të drejta dhe të arësyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve;
- ✓ Vendosjen e standardeve të shërbimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit nga ofruesit e shërbimeve të këtyre standardeve;
- ✓ Monitorimin e performancës së ofruesve të shërbimeve për të vlerësuar nëse ata i përmbushin kushtet e përcaktuara me licencën e shërbimit si dhe caqet e përcaktuara me procesin tarifor;
- ✓ Themelimin dhe mbështetjen e Komisioneve këshilluese të konsumatorëve në shtatë regjionet e Kosovës;
- ✓ Hartimin dhe miratimin e rregulloreve, standardeve dhe vendimeve rregullatore në pajtim me autorizimet që ka në bazë të këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme;
- ✓ Inspektimin e standardeve të shërbimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të akteve ligjore të Autoritetit.

**2.3.8. Ndërmarrjet publike/kompanitë** -ndërmarrjet publike qëndrore, kompanitë rajonale të ujitjes dhe të Ujësllësit, janë të themeluara me Ligjin Nr. 05/L -009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe janë të kalsifikuara në këto grupe Ndërmarrja Publike Qendrore, Kompanitë Rajonale të Ujitjes, Kompanitë Rajonale të Ujësllësit, dhe Ndërmarrjet Publike Lokale.

Ndërmarrja Publike Qendrore: Ndërmarrja Publike Hidrosistemi “Iber Lepenc” Sh.A ka si trashëgimtare e Ndërmarrjes Publike “Iber-Lepenc”, Ndërmarrjes Publike Hidrometrike “Iber Lepenc” Holding SH.A dhe ndërmarrjes Hidroekonomike Iber – Lepenc SH.A është përgjegjëse për asetet, pasurinë dhe gëzon të drejta dhe detyrime që vijnë si pasojë e këtij transformimi. Në fushëveprimtarinë e vet, ndërmarrja ka si përgjegjësi;

Furnizimin me ujë të papërpunuar, të akumuluar në liqenin “Ujman”, për shfrytëzuesit si:

- ✓ Industria (Trepça, KEK-u dhe Feronikeli)
- ✓ Ujësjiellësi Rajonal (Mitrovicë e Prishtinë) dhe
- ✓ Bujqëia (Mirëmbajtja dhe furnizimi i rrjetit për ujitje deri në hidrant).
  - ✓ Prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike;
  - ✓ Mirëmbajtja dhe operimi i objekteve hidrometrike të Ndërmarrjes;
  - ✓ Mbrojtja në objektet të hidrosistemit nga ujërat;
  - ✓ Mbrojtja e ujërave në objektet të hidrosistemit nga ndotja;
  - ✓ Kultivimi dhe shitja e peshqve në objektet e hidrosistemit,;
  - ✓ Kultivimi dhe shitja e këpuardhave në objektet e hidrosistemit;
  - ✓ Aktivitetet e nevojshme lidhur me implementimin e fazës së dytë Lepenci,; dhe
  - ✓ Aktivitete tjera, në pajtim me natyrën e veprimtarisë së ndërmarrjes.

### **Kompanitë Rajonale të Ujitjes:**

**Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë SH.A Pejë dhe Kompania e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini SH.A Gjakovë** kanë përgjegjësi në fushëveprimtarin e vet;

- ✓ Shërbimi i furnizimit me ujë
- ✓ Mirëmbajtjen e sistemit(eve) të ujitjes
- ✓ Grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit;
- ✓ Ndërtimin e ulët dhe të lartë të objekteve ujitëse, portave kontrolluese dhe digave
- ✓ Shoqëria ka si veprimtari shërbimet e përgjithshme publike
- ✓ Shoqëria do të kryejë çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive të saj, për të cilat kërkohen këto dokumente administrative.
- ✓ Veprimtaria e shërbimeve të përgjithshme publike .

### **Kompanitë Rajonale të Ujësjiellësit:**

Kompania Rajonale e Ujësjiellësit Prishtina SH.A, Kompania Rajonale e Ujësjiellësit Hidrodrini sh.A, Pejë Kompania Rajonale e Ujësjiellësit Mitrovica sh.A, Mitrovicë, Kompania Rajonale e Ujësjiellësit Hidromorava sh.A, Gjilan, Kompania Rajonale e Ujësjiellësit Radoniqi SH.A, Gjakovë, përgjegjësi në fushëveprimtari të Shoqërisë ka:

- ✓ Shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm.
- ✓ Mirëmbajtjen e sistemit(eve) të furnizimit me ujë të pijshëm;
- ✓ Prodhimi dhe/ose blerja e ujit të pijshëm për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
- ✓ Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit ujërave të zeza;
- ✓ Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të zeza si dhe të impianteve të tyre.
- ✓ Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar, i cili lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislati në fuqi.

- ✓ Shoqëria do të kryejë çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive të saj, për të cilat kërkohen këto dokumente administrative.

**Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidroregjioni Jugor SH.A, Prizren** në veprimtarinë e Shoqërisë ka përgjegjësi:

- ✓ Depozitimi, trajtimi dhe shpërndarja e ujit ( shërbimi i furnizimit të konsumatorëve me ujë);
- ✓ Punime të tjera të specializuara në ndërtime;
- ✓ Transporti rrugor i mallërave;
- ✓ Transporti i kanalizuar me anë të gypave;
- ✓ Magazinimi i mallit;
- ✓ Dhënja me qira e pasurisë së patundshme vetijake;
- ✓ Këshillimi dhe sigurimi i pajisjeve programore (Softvera-it);
- ✓ Veprimtari të arkitekturës dhe inxhinierisë dhe këshillime;
- ✓ Pastrimi dhe evitimi i ujërave ndotëse, trajtim i hllurinave, veprimtari sanitare të ngjashme,
- ✓ Mund të realizoj çdo lloj operacioni financiar apo tregtar, i cili lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;
- ✓ Do të kryej çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive të saj, për të cilat kërkohen këto dokumente administrative.

#### **Ndërmarrjet Publike Lokale:**

Kompania e Ujësjellësit dhe Mbeturinae Ibri, Zubin Potok, Zubin Potoku;  
Kompania e Ujësjellësit dhe Mbeturinae 24 Nëntori, Leposaviq ,Leposaviqi;  
Kompania Rajonale e Ujësjellësit Bifurkacioni sh.A, Ferizaj;

**2.3.9. Shërbimi Gjeologjik i Kosovës** konform Ligjit Nr. 06/L -039 për Shërbimit Gjeologjik të Kosovës ka përgjegjësi ligjore:

- ✓ Hulumtime themelore gjeologjike, hulumtime aplikative gjeologjike, studime gjeologjike sistematike bazë në tokë, në liqene, në territorin e Republikës së Kosovës, nëpërmjet hartografimeve komplekse të shkallëve të ndryshme;
- ✓ Studime gjeokimike të territorit dhe përpilimin e hartave gjeologjike në shkallë të ndryshme;
- ✓ Studimet të thelluara shkencore për gjeologjinë dhe metalogjeninë, studime dhe hulumtime gjeofizike të çdo shkalle me qëllim të studimit të korës së tokës në ose në afërsi të sipërfaqes së tokës, formacionet të ndikuara nga shpërndarja horizontale

- dhe vertikale të brendshme e vetive fizike në fushat e ndryshme gjeologjike;
- ✓ Studime për promovim të perspektivës së mineraleve të dobishme dhe vlerësimin ekonomik të tyre;
- ✓ Studime dhe hulumtime hidrogeologjike, ujërave nëntokësore, ujërave minerale dhe gjeotermal;
- ✓ Hulumtime dhe studime gjeologo-inxhinierike dhe të gjeorrezive;
- ✓ Studimet gjeologjike komplekse për gjeomjedisin në funksion të planifikimit të territorit;
- ✓ Studime dhe vlerësime të gjeomonumenteve;
- ✓ Hulumtime dhe vlerësime të mineraleve metalore, jo metalore, energjetike, hidrokarbureve, mineraleve industriale, gurët e çmuar dhe gjysmë të çmuar;
- ✓ Hulumtime dhe studime të përgjithshme paleontologjike, stratigrafike, sedimentologjike, petrografike, mineralogjike, kimike, gjeomorfologjike, gjeodinamike, gjeologjiko strukturore dhe gjeostatistike;
- ✓ Kryen shërbime të kualifikuara, ekspertiza, këshillime, monitorime për hulumtime gjeologjike, përgatit projekte për institucione të tjera, publike për hulumtime gjeologjiko-inxhinierike dhe gjeoteknike, si dhe punë tjera në bazë të këtij ligji;

**2.3.10. Organizatat Joqeveritare** konform Ligjit Nr. 06/L- 043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare kanë përgjegjësi të:

- ✓ Ushtrjnë veprimtarinë në mënyrë të pavarur nga institucionet publike.
- ✓ Institucionet publike bëjnë publike të gjitha format e bashkëpunimit dhe përkrahjes së OJQ-ve.

Gjithashtu për sa i përket edhe Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit përcakton qe:

- ✓ OJQ të marrin pjesë në hartimin e Planeve të veprimit lokal dhe programeve mjedisore se bashku me publikun, organizatat profesionale dhe komuniteti i biznesit (Neni 24).
- ✓ Dhe në nenin 44 përcakton qe të jepen mirënjohje dhe shpërblime për zhvillimin dhe përparimin e mbrojtjen së mjedisit.

Konform Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, Neni 20 përcaktohet qe Ministria të themeloj si organ i pavarur Institutin e Kosovës për ujëra me qëllim të zhvillimit dhe përparimit hulumtues dhe projektues.

### 3. MENAXHIMI I RESURSEVE UJORE

Autoriteti kompetent për qeverisjen dhe menaxhimin e ujërave në Kosovë është Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit dhe mbështetet nga ana e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), e cila monitoron gjendjen e mjedisit.<sup>3</sup>

#### 3.1. Planifikimi dhe menaxhimi i ujërave

Me planifikimin dhe menaxhimin e resurseve ujore të Kosovës merret Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (me tekstin e mëtejshëm ARPL), i cili funksionon brenda Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.

Në kuadër të ARPL-së, ekzistojnë tri divizione:

- Divizioni i Planifikimit të Resurseve Ujore (DPRU);
- Divizioni i Menaxhimit të Resurseve Ujore (DMRU);
- Divizioni për Pagesa Ujore dhe Projekte (DPUP).

##### 3.1.1. Sistemi Informativ Ujor (SIU)

Sistemi Informativ Ujor (SIU), funksionon në kuadër të Divizionit të Planifikimit të Resurseve ujore. Sistemi informativ i ujërave përbëhet nga baza e të dhënave, të dhënat e arkivuara, katalogu informativ, libri i ujërave, rrjeti komunikues me teknologjinë informative GIS-in (Sistemi Gjeografik i Informacionit) rregullat, formularët, procedurat dhe aktivitetet e shfrytëzimit të të dhënave dhe sistemit.

Sistemi informativ i ujërave përfshin të dhënat për:

- Sasinë dhe cilësinë e ujërave,
- Protokolin ujor dhe kadastrin e sistemit ujor,
- Protokolin e të gjitha lejeve ujore,
- Regjistrin e të gjitha substancave të shkarkuara nga bartësit e lejes ujore,
- Masat për rehabilitimin dhe programet për mbrojtjen e ujërave,
- Incidentet e dëmtimit të ujërave dhe aksidentet mjedisore,
- Regjistrin e materieve të rrezikshme për shëndetin publik dhe mjedisin,
- Analizat e ndikimeve të materieve të rrezikshme dhe
- Regjistrin me të dhënat e ndërtimeve, instalimeve apo deponimeve ekzistuese që janë të rrezikshme.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ 12/2013 për Sistemin Informativ Ujor, detyrat e Sistemit Informativ Ujor, janë si në vijim:

- mbledhja, grumbullimi, evidentimi dhe ruajtja e të dhënave në një sistem të organizuar;
- hartimi dhe udhëheqja e procedurave për administrimin e të dhënave ose informacioneve (përgatitja, bartja, azhurinimi, prezantimi, shpërndarja e informacioneve);
- avancimi i sistemit dhe kontrolli i vlefshmërisë së të dhënave ose informacioneve nga

zonat e administrimit me ujërat;

- regjistrimi, sigurimi, mbrojtja, mirëmbajtja e të dhënave, përkrahja për zhvillimin e sistemit të bazës së të dhënave dhe mbështetja materiale e tij;
- Organizimi i bazës së të dhënave për ujërat me teknologji të avancuar;
- përbushja e detyrimeve ligjore për informimin e publikut në nivel nacional dhe ndërkombëtar sipas standardeve të Bashkimit Evropian dhe Konventave Ndërkombëtar për Ujërat;
- Shkëmbimi dhe harmonizimi i të dhënave dhe informacioneve me sistemet tjera informative homologe.

### 3.1.2. Mbrojtja e ujërave

Për të mbrojtur ujërat e Kosovës duhet respektuar parimet e menaxhimit të qëndrueshëm, çka është objektivi edhe i Strategjisë së ujërave të Kosovës.

Mbrojtja e ujërave është sfidë për të gjitha institucionet që janë përgjegjëse për menaxhimin e tyre. Gjendja aktuale e trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Kosovës, është në fazën e investimeve të vazhdueshme, duke filluar nga studimi i fizibiliteteve për shtatë qendrat e mëdha urbane, vazhduar me vendbanime më të vogla, deri te qendrat e bizneseve etj. Me përkrahje të donatorëve të jashtëm janë kryer studime të fizibilitetit për trajtimin e ujërave të zeza për shtatë qendrat rajonale, atë të regjionit të Prizrenit, Gjakovës, Pejës, Gjilanit, Ferizajt, Mitrovicës, Prishtinës. Studimi i fizibilitetit për regjionin e Prizrenit, Gjakovës dhe Pejës është financuar nga KFW (Banka Gjermane për Zhvillim) dhe Qerveria e Kosovës, ndërsa studimi i fizibilitetit për trajtimin e ujërave urbane për regjionin e Gjilanit, Ferizajt, Prishtina dhe Mitrovicës, është financuar nga BE.

Gjithashtu nga Qeveria Zvicerane janë duke u investuar në fushën e trajtimit të ujërave në zonat rurale me fizibilitet të 18 vendbanimeve, ku në fazën e implementimit janë katër vendbanime; Orllan - K.Podujevë, Marmull - K.Gjakovë, Lokvicë - K.Prizren dhe Shallc - K.Vushtri, me kosto të përafërt 1.2 Milion Euro.

Paratrajtimi i ujërave kërkon në marrjen e disa veprimeve si;

- o grumbullimi i ujërave të ndotura nga amvisëria (sistemi i kanalizimit publik);
- o grumbullimi i ujërave të ndotura nga industria ekstraktive dhe përpunuese (sisteme të veçanta);
- o grumbullimi i ujërave atmosferike (shiu, bora etj. - sisteme publike);
- o trajtimi i ujërave të ndotura (infrastruktura);
- o monitorimi i parametrave të shkarkimit të ujërave të ndotura në recipient.

Impiantet për trajtim të Ujërave të Zeza, të ndërtuara janë në: Llaushë - K.Skenderaj, Fshatin Harilaq, burgi i Dubravës dhe ai i Lipjanit, Parku i bizneseve në Drenas, e të tjera me kapacitet dhe kosto më të ulët.

Në mbrojtjen e ujërave futën edhe masat në raste si;

- Vërshimet (rregullimi i segmenteve lumore, masat biologjike, muret mbrojtëse nga vërshimat, gabionet, argjinaturat etj.)
- Kapërderdhjet (muret mbrojtëse, ngritje të terrenit me mbushje artificiale, etj.)
- Erozioni (bankinat malore, pyllëzimi, mbrojtje të pyjeve etj.)
- Kullimi (kanalet e drenazimit etj.)
- Tharja (kanalet e drenazimit, mbushje, injektive etj.)
- Thatësia (sistemet për paralajmërim të hershëm)
- Ndryshimet klimatike

### 3.1.3. Zonat e mbrojtura ujore dhe sanitare

**Zonë e mbrojtur ujore** është një hapësirë ujore e përcaktuar qartë gjeografikisht, e njohur, me kufij të qartë fizikë dhe e menaxhuar përmes mjeteve ligjore apo mjeteve të tjera të efektshme, për të arritur ruajtjen/mbrojtjen afatgjatë si dhe vlerat e ekosistemit të saj.<sup>4, 5</sup>

Zonat e mbrojtura ujore janë:

- zonat e mbrojtura sanitare;
- zonat e mbrojtura për qëllime strategjike; dhe
- zonat e mbrojtura ekologjike (Natura 2000).<sup>6</sup>

**Zonat e mbrojtura sanitare** janë ato zona të cilat shfrytëzohen dhe mund të shfrytëzohen në të ardhmen për furnizimin me ujë të popullsisë. Zonat e mbrojtura sanitare kanë për qëllim të mbrojnë burimet ujore nga ndikimet negative të cilat mund të dëmtojnë gjendjen normale dhe të qëndrueshme të ujit nga aspekti i cilësisë dhe sasisë<sup>7</sup>.

Zonat e mbrojtura sanitare ndahen në tri zona:

**Zona e I-rë** – Zona e mbrojtjes së regjimit të rrept caktohet për mbrojtjen e rrept të drejtpërdrejtë rreth burimit të ujit dhe objekteve me instalime për marrjen e ujit si dhe të mbrojtje burimit nga shkarkimet e ndotësve që mund të drejtpërdrejtë të ndikojnë në ujë nga aktiviteti i njeriut.

**Zona e II-të** – Zona e mbrojtjes së regjimit të kufizuar sipërfaqja e kësaj zone duhet të jetë e mjaftueshme që të siguroj mbrojtje nga lëvizjet e ndotësve mikrobiologjik, kimik dhe llojeve të tjera të ndotësve.

**Zona e III-të** – Zona e mbrojtjes së regjimit të lehtë sipërfaqja e kësaj zone paraqet mbrojtjen parandaluese për pellgun përkatës të burimit ujor dhe rrit efikasitetin e mbrojtjes nga ndotja kimike radioactive.

Zonat e mbrojtura ujore shpallen nga Qeveria, me propozim të ministrisë përkatëse për mjedis.

Në Kosovë deri me tani janë shpallur 34 Zona të Mbrojtura Sanitare ( shih Tabelen 2).

4 B. Mustafa, E. Hoxha, “Biodiversiteti dhe Zonat e Mbrojtura”, Prishtinë, 2004.

5 Ligj Nr. 81/2017 për Zonat e Mbrojtura, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, 2017.

6 Ligji Nr. 04/l-147 për Ujërat e Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2013.

7 Udhëzimi Administrativ, Nr. 28 për Zonat e Mbrojtura Sanitare, MMPH, Republika e Kosovës, 2004.



Table 2. Burimet ujore si zona të mbrojtura

Nr.	Pellgu	Emri i Burimeve	Nënshkrimi në Qeveri	Nr. i protokollit të vendimit
1	DB	BD. Akumulimi "RADONIQ", Komuna Gjakovës	24.04.2013	09/127
2	DB	FB. Burimi "ISTOG", Komuna e Istogut	24.04.2013	10/127
3	DB	FB. Burimi "Vrellë", Komuna e Istogut	24.04.2013	11/127
4	DB	MG. Burimet "Goçit, Lipovices dhe te Livadhet"	24.04.2013	12/127
5	DB	MG. Burimi i "Shkozës" Komuna e Malishevës	24.04.2013	13/127
6	DB	MG. Burimi i "Drini i Bardhë"	24.04.2013	14/127
7	DB	MG. Burimi "Uji i Zi, Uji i Bardhë, Galerija dhe Drenazha"	24.04.2013	15/127
8	I	BD. Akumulimi i "BADOVCIT"	24.04.2013	16/127
9	I	BD. Akumulimi i "BATLLAVES", Komuna e Podujevës	24.04.2013	17/127
10	MB	SR. Burimi "BAJA"	24.04.2013	18/127
11	MB	SR. Burimi "GURI I HOXHES"	24.04.2013	19/127
12	MB	SR. Burimi "LETNICË", Komuna Viti	24.04.2013	20/127
13	MB	SR. Akumulimi i "PERLEPNICES" Komuna Gjilan	24.04.2013	21/127
14	L	SL. Burimi "PRROI I SYLES" në Komuna Ferizaj	24.04.2013	22/127
15	L	LM. Burimi "PRROI I PUKES" në Komuna Ferizaj	24.04.2013	23/127
16	L	LM. Burimi "LUMI I VOGEL" në Komuna Ferizaj	24.04.2013	24/127
17	DB	MG. Puset e Jarines në Klinafç, Komuna Klinë	18.06.2014	02/191
18	DB	MG. Puset në Klinë dhe kaptimi në lumin Drini i Bardhë, Komuna Klinë	18.06.2014	03/191
19	DB	MG. Puset 1,2,3 në Fidanishte dhe 1,2,3, në Topallnicë, Komuna e Suharekës	18.06.2014	04/191
20	DB	MG. Pusi i Atit 1,2,3,4,5 në Malsi të re (Shpenadi), Komuna Suharekës	18.06.2014	05/191
21	DB	MG. Puset 1,2,3 në Banjë-Malishevë, Komuna e Malishevës	25.06.2014	02/192
22	DB	MG. Kaptazha në lumin Radeshë, Komuna Dragash	25.06.2014	03/192
23	DB	MG. Bunarlyk 1,2 dhe puset 1,2,3, Komuna Prizren	25.06.2014	04/192
24	DB	MG. 40 Bunarët te ura, Komuna Prizren	25.06.2014	05/192
25	DB	MG. Vrella në Semetisht, Komuna Suharekës	28.08.2015	10/46
26	DB	MG. Vrella në Reshtan, Komuna Suharekës	28.08.2015	09/46
27	DB	MG. Puset dhe kaptimet Sallagrazhd, Komuna Suharekës	28.08.2015	08/46
28	DB	MG. Drenazha I dhe II me kaptazha-SOPI, Komuna e Suharekës	28.08.2015	07/46
29	DB	SR. Puset ne K. Lipjanit - Fabrika e letres-Komuna Lipjan	28.08.2015	11/46
30	DB	"Pusi 1,2,3 në Samadraxhë, Komuna e Suharekës	28.08.2015	04/46

31	DB	MG. Vrella dhe pusi në Doberdelan, K. Suharekës	28.08.2015	05/46
32	DB	MG. Vrella në Studençan. K. Suharekës	28.08.2015	04/46
33	DB	MG."Vrella Mushitisht" në Mushitisht, K. Suharekës	28.08.2015	03/46
34	DB	MG."Pusi Juglindor " Savrovë, Komuna e Suharekës	28.08.2015	02/46

**Shënim: DB-Drini Bardhë; I-Ibër; L-Lepenc; MB-Morava e Binçes**

**Zonat e mbrojtura për qëllime strategjike** – Janë ato zona të cilat përdorën për qëllime strategjike. Përgjegjës për përcaktimin e kufirit të zonave të mbrojtura strategjike është ministria në bashkëpunim me ministritë e linjes, komunat, komuniteti që banon në afërsi të zonës dhe shoqërisë civile.

Ministria harton propozimin për formimin e grupit punues profesional për përcaktimin e kufirit të zonës së mbrojtur strategjike. Vendimin e nxjerr Kryeministri i Kosovës. Akoma nuk kemi një zone të mbrojtur për qëllime strategjike.

**Zonat e mbrojtura ekologjike (Natura 2000)** Natura 2000 paraqet sistemin kryesor të politikave të BE-së për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit. Është rrjet i gjerë i zonave të mbrojtura në BE. Qëllimi i këtij rrjeti ekologjik është të siguroj mbijetesë afatgjate të llojeve të gjalla dhe habitatetve të cilët janë në rrezik të zhdukjes<sup>8</sup>.

#### 3.1.4. Zonat e ndjeshme (sensitive) ujore

Zonat e ndjeshme ende nuk janë të përcaktuara në territorin e vendit. Zonat e ndjeshme duhet të përcaktohen me vendim të Ministrisë sipas UA Nr. 30/2014, kryesisht për zonat e ujit ku uji përdoret për pije (liqejt), me monitorim të nitrateve dhe fosfateve.

#### 3.1.5. Pellgjet dhe nënpellgjet ujore

Kosova ka katër pellgje ujore si:

- Pellgu lumor Drini i Bardhë,
- Pellgu lumor Ibrër,
- Pellgu lumor Morava e Binçes dhe
- Pellgu lumor Lepenc (Fig. xx).

Ndarja e nënpellgjeve ujore në Kosovë si kriter bazë është marr duke vlerësuar shpërndarjen e trupave ujorë sipërfaqësor dhe nëntokësor. Në përgjithësi janë 82 nënpellgje ujore, të cilat do t'i paraqesim në formën tabelare si dhe në hartë tematike e karakterit informativ (Tabela 3 dhe Figurat 9, dhe10).

<sup>8</sup> <https://www.eea.europa.eu/themes/biodiversity/natura-2000/the-natura-2000-protected-areas-network>

Tabela 3. NënPELLGJET UJORE

Nr.	Emri i nënpellgut	PAR	CODI	Nr.	Emri i nënpellgut	PAR	CODI
1	Nenpellgu i Lumit Beranica	04	04_01	42	Nenpellgu i Lumit te Ceranit	02	02_12
2	Nenpellgu i Lumit te Cernices	04	04_02	43	Nenpellgu i Lumit te Bistrices	02	02_13
3	Nenpellgu i Lumit Pasjan	04	04_03	44	Nenpellgu i Lumit te Llapit	02	02_14
4	Nenpellgu i Lumit te Perlepnices	04	04_04	45	Nenpellgu i Lumit te Soqanes	02	02_15
5	Nenpellgu i Lumit te Shtrember	04	04_05	46	Nenpellgu i Lumit te Leposaviqit	02	02_16
6	Nenpellgu i Lumit Gercanica	04	04_06	47	Nenpellgu i Lumit Trudan	02	02_17
7	Nenpellgu i Lumit Llapushnice	04	04_07	48	Nenpellgu i Lumit te Drenit	02	02_18
8	Nenpellgu i Lumit te Livoqit	04	04_08	49	Nenpellgu i Lumit Bistrica	02	02_19
9	Nenpellgu i Lumit Gryka	04	04_09	50	Nenpellgu i Lumit Trbicka	02	02_20
10	Nenpellgu i Lumit Sojeves	04	04_10	51	Nenpellgu i Lumit te Drenoves	02	02_21
11	Nenpellgu i Lumit te Zhegres	04	04_11	52	Nenpellgu i Lumit te Joshanices	02	02_22
12	NënPELLGU i Pronit të thatë	03	03_01	53	Nenpellgu i Lumit Drenica	02	02_23
13	Nenpellgu i Krivenikut	03	03_02	54	Nenpellgu i Lumit te Brosovaces	02	02_24
14	NënPELLGU i Përronit të madh	03	03_03	55	Nenpellgu i Lumit te Lushtes	02	02_25
15	Nenpellgu i Lumit te Rapotit	03	03_04	56	NënPELLGU i Lumit Bërnyaçka	02	02_26
16	Nenpellgu i Lumit te Dubraves	03	03_05	57	NënPELLGU i Lumit të Siçevës	02	02_27
17	NënPELLGU i Lumit të Kavaçevës	03	03_06	58	Nenpellgu i Lumit "Rovacki"	02	02_28
18	Nenpellgu i Lumit "Bicevaçka"	03	03_07	59	NënPELLGU i Lumit të Zubin Potokut	02	02_29
19	Nenpellgu i Ortices	03	03_08	60	Nenpellgu i Lumit te Pades	02	02_30
20	Nenpellgu i Lumit Radushka	03	03_09	61	Nenpellgu i Lumit te Kosareves	02	02_31
21	Nenpellgu i Lumit se Kotlines	03	03_10	62	Nenpellgu i Lumit te Banjskes	02	02_32

22	Nenpellgu i Lumit të Kalludres	03	03_11	63	Nenpellgu i Lumit Lucka	02	02_33
23	Nenpellgu i Lumit Murzica	03	03_12	64	Nenpellgu i Lumit te Zupqanit	02	02_34
24	Nenpellgu i Lumit te Thate	03	03_13	65	Nenpellgu i Lumit te Gadimes	02	02_35
25	Nenpellgu i Lumit "Suva Reka"	03	03_14	66	Nenpellgu i Lumit te Shtimjes	02	02_36
26	Nenpellgu i Lumit Susic	03	03_15	67	Nenpellgu i Lumit te Gerkajes	02	02_37
27	Nenpellgu i Lumit Lumi i thate	03	03_16	68	nenpellgu i Lumit te Dobraves	02	02_38
28	Nenpellgu i Lumit te Rikovcit	03	03_17	69	Nenpellgu i Lumit Erenik	01	01_01
29	Nenpellgu i Lumit te Tatnjankes	03	03_18	70	Nenpellgu i Lumit te Plaves	01	01_02
30	Nenpellgu i Lumit Plesinac	03	03_19	71	Nenpellgu i Lumit Lumbardhe i Pejes	01	01_03
31	Nenpellgu i Lumit Prishtevka	02	02_01	72	Nenpellgu i Lumit te Istogut	01	01_04
32	Nenpellgu i Lumit te Sudimles	02	02_02	73	Nenpellgu i Lumit te Restelices	01	01_05
33	Nenpellgu i Lumit Smrekovnice	02	02_03	74	Nenpellgu i Lumit Bistrice e Deqanit	01	01_06
34	Nenpellgu i Lumit Tërstena	02	02_04	75	Nenpellgu i Lumit Mirusha	01	01_07
35	Nenpellgu i Lumit te Janjeves	02	02_05	76	Nenpellgu i Lumit Shushice	01	01_08
36	Nenpellgu i Lumit Graqanica	02	02_06	77	Nenpellgu i Lumit Bistrice e Prizrenit	01	01_09
37	Nenpellgu i Lumit te Zhegovcit	02	02_07	78	Nenpellgu i Lumit Toplluga	01	01_10
38	Nenpellgu i Lumit te Kamenices	02	02_08	79	Nenpellgu i Lumit Klina	01	01_11
39	Nenpellgu i Lumit te Vuqines	02	02_09	80	Nenpellgu i Lumit Prue	01	01_12
40	Nenpellgu i Lumit te Barit	02	02_10	81	Nenpellgu i Lumit "Ribinicka"	04	04_12
41	Nenpellgu i Lumit te zi	02	02_11	82	Nenpellgu i Lumit Llastice	04	04_13




Figura 9. Harta e pellgjeve lumore të Kosovës



## Ujërat Sipërfaqësor (lumenjtë dhe pellgjet lumore)

Sipërfaqja ujëmbledhëse topografike e Kosovës është 11.645 km<sup>2</sup>, ndërsa vetëm akumulimet ekzistuese janë 569.690.00 m<sup>2</sup>. Lumenjtë më prurje me të mëdha brenda vitit janë në Pellgun e Drinit te Bardh në Rrafshin e Dukagjinit.

Në aspektin hidrografik Kosova ndahet në 4 pellgje lumore (fig. 11):<sup>9</sup>

- **Drini i Bardhë** me degët: Lumëbardhi i Pejës, Lumëbardhi i Deçanit, Lumi i Erenikut, Lumi i Istogut, Lumi i Klinës, Lumi Mirusha, Lumi Rimmiku, Lumi Toplluha dhe Lumëbardhi i Prizrenit,
- **Ibri** me degën kryesore Sitnica (Graçanicës, Prishtevka (Lumi Prishtinës), Sllakovaqa, Studime, Sazlia, Caraleva, Llapi, Drenica, Trepça, Smrekovnica, Gojbules, Dumnica), dhe Lushta, Kozareva, Bajskes, Kamenica, Vuça, Gërkaja, Jashanica, Borogllava, Vraqeva, Trebiçka, Bistrica, Ceraja, Mushnica, Dubrava, Jagnjeniqa, Brusovaqa, Bernjaka, Çeçeva, Zubodolli (Albanikut), Zubqana, Drena, Tverdan, Leposaviqi dhe Sllatina,
- **Morava e Binçës** me degën kryesore Kriva Reka, Desivojca, Perlepnica, Gjilanit, Livoçi, Cernica, Smira, Pogragja, Vilastica, Ribniku, Svintulbkes, Llapushnica, Pasjani, Zhegra, Letnica, Pakita (Beranica),
- **Lepenci** me degën kryesore Lumi Nerodime, Ortica, Kavaqeva, Dubrava, Biqeva, Verbeshtica, Suva Reka, Sushica, Ropot, Prroi i Thatë, Murzhica, Kotlina, Koshtanjeva, Kerveniku.
- **Lumi Plava** me Lumin Restelica, Brod, Radesha, Kapra, Karaxha, Renci, Belobrada, Brodosava, Bljaqa.




Figura 11. Harta e pellgjeve lumore

Lumenjtë më të rëndësishëm janë:

- Drini i Bardhë
- Lumbardhi i Pejës
- Lumbardhi i Deçanit
- Lumbardhi i Prizrenit
- Ereniku
- Toplluha
- Mirusha
- Klina
- Istogu
- Ibri
- Sitnica
- Llapi
- Drenica
- Lepenci
- Morava e Binçës dhe
- Kriva Reka(Tabela 4).

Tabela 4. Të dhënat themelore për lumenjt dhe pellgjet ujore

Lumi	S i p . ( S ) Km <sup>2</sup>	Gjat. e lu- mit(L) Km	Prurja (Q) m <sup>3</sup> /S	(q) l/sek/ km <sup>2</sup>	Pjerr. %	Perim. i pellg. Km	Rrjedh. Vjetore X10 <sup>6</sup> /m <sup>3</sup>	Reshje efekt. mm	Reshje Mes. mm	Koef.i Rrjedh.
Drini i Bardh	4340.14	110.7	61.7		2.1	409.8	1946	452.5	900	0.508
Sushica	49.4	17.25			9.4	32			1150	
LB.i Pejës	464.8	54	10.21	24.13	2.5	128	200.66	760.1	1168	0.651
LB. i Deçanit	259.3	53	7.84	42.46	3.2	105	152.46	1337.4	1530	0.874
Ereniku	519.3	51.74	12.16	26.73	3.9	109	383.04	841.8	1515	0.716
Istogu	405.3	19.74	6.98		4.5	87			1200	
Klina	458.7	72.12	2.8	4.92	4.5	126	65.52	154.9	750	0.221
Mirush.	336.7	37	1.661		1.7	83			700	
Toplluh.	495	34.05	3.44		3.5	108			1000	
LB. Prizren	247.8	36.07	6.49	29.68	7.4	77	147.74	935.1	960	0.974
Plava Restelic	341.86	22.12	5.25	20.79	5.9	90.56	165.06	655	1080	0.644
<b>Totali i pellgut</b>	<b>4682</b>	<b>110.7</b>	<b>61.01</b>		<b>2.1</b>	<b>409.8</b>	<b>1946</b>	<b>452.5</b>	<b>900</b>	<b>0.508</b>
Ibri	4044.21	89.5	36.4	6.39	0.3	436.8	1148	218.4	782	0.301



Sitnica	291.2	78	13.94	5.38	1.1	276	439.11	169.5	690	0.258
M.Binçes	1564	76	8.7	5.99	1.5	216	330	188.8	736	0.256
Kr.Reka	640.7	44.5	4.43	7.27	1.2	128	139.55	229.1	736	0.311
Lepenci	653	50	8.4	14.91	4.6	130	190	469.8	912	0.516
Nerodime	209.4	38.5			2.1	81.5			750	
<b>Totali i Përgjith.:</b>	<b>10907.00</b>		<b>121.2</b>				<b>3.8*10*</b>			

### 3.1.6. Liqenet ( Liqenet artificial, Liqenet natyrale)

Brenda territorit të Kosovës janë ndërtuar 6 akumulime infrastrukturore te ujërave sipërfaqësore, të paraqitura në tabel.(Tabela.5), (Figura.12)

Tabela 5. Akumulacionet sipërfaqësore në territorin e Kosovës

Rezervuari	Lumi	Sip. e ujëmbledhësit	Vëllimi milion m <sup>3</sup>		Viti i Ndërtimit	Lart. e digës	Territor nën sist. e ujitjes	Destinimi		
			Shfrytëzuesi	Gjithsej				Per ujite	Për pije	Industri
Gazivoda Ujmani	Ibër	1060	350	390	1979	101	Mitrovic, Vushtri, Prishtine, Skenderaj Drenas Zub.Potok	2 0 0 0 0 ha	Po	Po
Batllava	Batllavë	226	25.1	30	1960	46	Prishtinë Podujevë	Jo	Po	Po
Badovci	Gračanicë	103	20	26.4	1963	45	Prishtinë	Jo	Po	Po
Livoç	Livoç	53.6	-	-	-	-	Gjilan	Jo	Jo	Jo
Radoniq	Përrue	130	102	116.6	1982	61	Gjakovë Rahovec Prizren	1 0 0 0 0 ha	Plo	Jo
Prilepnicë	Prelepnicë	62	-	-	1982	40	Gjilan	Jo	Po	Jo
Gjithsej		1634.6	497.1	563						



Figura 12. Harta e rrjetit hidrografik dhe akumulimet sipërfaqësore të Kosovës<sup>10</sup>

Sipas Planit Strategjik të ujrave janë të parapara te ndërtohen edhe akumulacione tjera. (shih Figuren 3).




Figura 13. Harta e akumulacioneve ekzistuese dhe planifikuese

<sup>10</sup> Agjencioni Statistikave të Kosovës

### 3.1.7. Ujërat Nëntokësor (Burimet Ujore)

Rezervat e ujërave nëntokësor në Kosovë vlerësohen se janë të kufizuara. Ato gjenden kryesisht në pjesën perëndimore të vendit.

Gjatë periudhës 2005-2007 në kuadër të projektit “Zhvillimi i resurseve ujore në Kosovën Juglindore” janë bërë hulumtime gjeofizike për ujërat nëntokësore në territorin e komunës së Gjilanit dhe komunës së Ferizajt (Pellgu i Moravës së Binçes). Ndërsa gjatë periudhës 2008-2010 me mbështetjen e Komisionit Evropian, përmes projektit për Pellgun e Drinit të Bardhë, në kuadër të aktiviteteve të projektit është bërë edhe planifikimi i pikave të hulumtimit për ujërat nëntokësore në këtë pellg. Të dhënat historike flasin se kjo është zona më e pasur me ujëra nëntokësore në Kosovë.

Sipas Master Planit për Ujëra e Kosovës 1983-2000, potencialet më të mëdha të ujërave nëntokësore gjenden në rrafshin e Dukagjinit.(shih Tabelen 6)

Tabela. 6. Akumulimet nëntokësore ujore në Pellgun e Drinit të Bardhë, sipërfaqja, vëllimi dhe kapacitetit i tyre.

Nr.	Akumulimi nëntokësor	Pellgu km <sup>2</sup>	Vëllimi i dobishëm m <sup>3</sup>	Kapaciteti vlerësues m <sup>3</sup> /sek	Gjithsejt/m <sup>3</sup>
1	Istog	76	12x106	2.8	89x106
2	Vrellë	28	14x106	0.600	19x106
3	Drini i Bardh	90	14x106	3.23	102x106
4	Lubizhdë	42	45x106	4.2(150)	55x106
5	Pejë	300	37.5x106	4.0(150)	52x106
6	Deçan	144	33x106	3.5(150)	45x106
7	Lloqan	39	12x106	1.2(150)	15x106
8	Krk Bunar	81	10x106	1.6	50x106
9	Korishë	18	3.6x106	0.38	12x106
10	Fusha e Therandës	50	75x106	2	63x106
<b>Gjithsej</b>		998	271x106		511x106

### 3.1.8. Ujërat termo-minerale

Republika e Kosovës ka burime të rëndësishme të ujërave termale të cilat shfrytëzohen kryesisht për qëllime shërimi dhe rekreacioni.

Hulumtime për identifikimin dhe studimin e vlerave të këtyre burimeve si dhe sasinë e këtyre ujërave akoma janë të paktë. Deri me tani janë të identifikuar rreth 30 burime të ujërave termale dhe minerale (Tab.7).

Hulumtime më të detajuara janë kryer vetëm për Banjën e Pejës(fig.14), të Kllokotit dhe të Banjskës, të cilat funksionojnë si banja termale shëruese. Përveç aspektit shërues këto ujëra termale mund të përdoren edhe për prodhimin e energjisë termike. Në përgjithësi temperatura e ujërave termominerale sillet prej 17 deri 54<sup>0</sup> C, ndërsa shkalla e mineralizimit prej 2-5 g/l. Burimet e ujërave termale dhe minerale kanë përmbajtje të sulfateve, hidrokarbureve, kalciumit dhe magnezit.



Figura.14. Burimi termomineral ne Banjë të Pejës

Tabela 7. Karakteristikat fiziko-kimike të disa burimeve termominerale

Nr.	Lokaliteti	Q l/sek	t °C	pH	Mineralizimi g/l
1	Banja e Pejës	4.0	48.9	6.9	2.04
2	Banja e Kllokotit	10.0	32.0	6.6	3.601
3	Banjska	2.50	50.0	6.7	1.356
4	Banja e Runikut	15.0	24.8	7.1	0.598
5	Burimi i nxehtë i Runikut	5.0	23.0	7.2	0.61
6	Gojbula	-	12.0	6.3	2.193
7	Uji i Lluzhanit	0.01	14.0	6.3	1.144
8	Studencia	1.0	25.0	7.1	0.670
9	Deçan	2.0	12.5	6.3	1.433
10	Getnja e Sipërme	0.1	9.0	6.6	2.539
11	Poneshi	0.03	13.0	6.3	3.539
12	Pokleki	1.0	13.0	6.3	3.52
13	Uglari	6.0	25.0	6.8	0.688
14	Zhitija	0.3	20.0	6.5	5.126
15	Dobërçani	-	26.0	6.4	-

Burimet e ujërave minerale dhe termo-minerale janë të shpërndara në tërë territorin e vendit ( shih Figuren 15).




Figura 15. Burimet ujore termo-minerale

### 3.1.9. Ligatinat

Kosova ka të shpallur një zonë të mbrojtur që kategorizohet si ligatinë. Ligatina e Hencit - Radevës, është zonë e veçantë e mbrojtur e zogjve që gjendet në afërsi të Aeroportit Ndërkombëtar “Adem Jashari” në mes të fshatrave, Henc, Vrellë dhe Radevë. Ligatina ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 109 ha 52 ari. Edhe pse i formuar në mënyrë artificiale, karakterizohet me vlera të veçanta natyrore si: ornitologjike, ihtiologjike, hidrogjeologjike, botanike, peizazhore etj. Për shkak të këtyre vlerave në vitin 2014 është nxjerr Vendimi për shpalljen e saj Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve. Ligatina e Hencit – Radeves, në aspektin floristik, kjo zonë është e pasur me lloje bimore.(shih Figuren 16). Ligatina e Hencit - Radeves është zonë e pasur edhe nga aspekti i zoodiversitetit ku deri më tani është konstatuar se jetojnë një numër i madh i llojeve të faunës së egër e prej tyre numrin më të madh e përfaqësojnë shpendët e egra me rreth 80 lloje.



Figura 16. Foto-Ligatina e Hencit/F.Bajraktari

## 4. SHFRYTËZIMI I RESURSEVE UJORE PËR EKONOMI

### 4.1. Shfrytëzimi i ujërave për pije dhe amvisëri

Furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës në vend e bëjnë shtatë Kompanitë Regjionale të Ujërave.(Tab.8). Kompanitë Regjionale të Ujërave furnizojnë më ujë vendbanimet urbane dhe një pjesë të vendbanimeve rurale. Një pjesë e popullatës furnizimin me ujë për ekonominë familjare shfrytëzojnë burime vetanake (puse, dhe burime tjera), të cilat nuk janë në menaxhim të kompanive regjionale si dhe as në monitorim të IKSHP. Sipas raportit të përformacës së Kompanive Regjionale të Ujërave, mbulueshmëria me shërbimin e ujësjellësve në zonën e KRU-ve gjatë viteve 2015-2019 është 75-91%.

Tabela 8. Kompanitë e licencuara për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura (Ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit): <sup>11</sup>

KRU “Prishtina” Sh. A.,	Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Lipjan, Shtime, Drenas dhe Graçanicë
KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A.,	Prizren, Malishevë, Suharekë Dragash dhe Mamushë
KRU “Hidrodrini” Sh.A	Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan
KRU “Mitrovica” Sh.A	Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri
KRU “Gjakova” Sh.A.,	Gjakovë, Rahovec dhe disa fshatra të Prizrenit
KRU “Hidromorava” Sh.A	Gjilan, Kamenicë dhe Viti
KRU “Bifurkacioni” Sh.A.,	Ferizaj dhe Kaçanik

Tabela 9. Furnizimi i ekonomive familjare më ujë të pijshëm në Kosovë 2015-2019<sup>12</sup>

Vitet	2015	2016	2017	2018	2019
Njesia	mil m <sup>3</sup> / vit				
Furnizimi me ujë të ekonomive familjare	50.37	52.33	49.194	48.300	49,014,648
Furnizimi me ujë Institucionet	4.631	4.662	5.134	6.554	6,922,027

Sasia e ujit të shpenzuar m<sup>3</sup> për banor nga ekonomitë familjare të mbikëqyruar në sistemin publik, në vitin 2018 ishte: 2.60 m<sup>3</sup> në muaj dhe 0.09 m<sup>3</sup> në ditë. Kurse e llogaritur në litra ishte: 86.67 litra/ditë për banor.

<sup>11</sup> ARRU-Raporti vjetor 2018

<sup>12</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës 2019

## 4.2. Shfrytëzimi i ujërave për ujitje

Shfrytëzimi i ujërave për ujitje gjatë vitit 2012, ka shënuar rritje në krahasim me vitin paraprak. Sipas të dhënave të Agjencionit të Statistikave të Kosovës dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjatë vitit 2015 për ujitje janë shpenzuar rreth 123 milion m<sup>3</sup> ujë, që shënon një rritje të ndjeshme në krahasim me vitet paraprake. Ndërsa nga viti 2016 fillon e bien ndjeshëm sasia e ujit të shpenzuar për ujitje (shih Figurën 17).




Figura 17. Sasia e ujit të shpenzuar për ujitje 2001-2019<sup>13</sup>

Krahas rritjes së sasisë së shfrytëzuar për ujitje është rritur edhe numri i sipërfaqeve të ujitura. Gjatë vitit 2012 janë ujitur rreth 12 mijë e 300 hektarë të tokave, që vitet në vijim shënohet rritje dhe se në vitin 2015 arrin maksimumin e sipërfaqeve të ujitura rreth 31 mijë e 300 hektarë. Ndërsa nga viti 2015 fillon e bien ndjeshëm sipërfaqet e ujitura (shih Figuren 18).




Figura 18. Sipërfaqet e ujitura 2001-2019<sup>14</sup>

13 Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
 14 Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



Nga dy grafiket, sasia e ujit të shpenzuar për ujitje dhe sipërfaqet e ujitura, shihet harmonizim i sasisë së ujit që shfrytëzohet për ujitje me sipërfaqet e ujitura.

### 4.3. Shfrytëzimi i ujërave në industri

Operatorët industrial konsiderohet si sektori më i madh i konsumit të ujit. Konsumatorët me të mëdhenjë industrialë të ujit në Kosovë janë ndërmarrjet si KEK, Neë Co Feronikeli, Sharrcem etj. Shumica e ndërmarrjeve industriale furnizohen nga ujërat sipërfaqësore nga liqenet akumuluese. Të dhënat tregojnë së ndërmarrjet e mëdha industriale për nevojat teknologjike, të proceseve të ftohjes, atyre sanitare, etj konsumojnë me shume se 30% të sasisë së konsumit total të ujit në Kosovë<sup>15</sup>.

Korporata Energjetike e Kosovës është njëri ndër operatorët ekonomik që shpenzon më së shumti ujë për qëllime të prodhimit të energjisë.

TC Kosova A furnizohet me ujë të papërpunuar nga Lumi Llap, dhe sipas nevojës edhe nga Hidrosistemi Ibër-Lepenc dhe Liqeni i Batllavës, ndërsa TC Kosova B furnizohet me ujë të pa përpunuar nga Hidrosistemi Ibër- Lepenc. Sipas të dhënave të KEK-ut, në vitin 2019 gjatë procesit të prodhimit të energjisë në këtë korporatë është përdorur rreth 16.3 milion m<sup>3</sup>, që krahasuar me vitin paraprak ka shënuar një ngritje prej 1.2 milion m<sup>3</sup> ujë më shumë se sa në vitin paraprak. (shih Figuren 19).




Figura19. Sasia e ujit të shpenzuar nga KEK-u gjatë procesit të prodhimit të energjisë 2009-2019<sup>16</sup>

NewCo Feronikel furnizohet me ujë për procesin teknologjike nga Bivolaku (hidrosistemi Ibër-Lepenc), i cili ndodhet 17 km larg nga fabrika. Ky ujë pranohet në basenet e ujit që ndodhen sipër fabrikës. Uji në Feronikël shfrytëzohet si: ujë industrial për nevojat e operatorit dhe një pjesë e vogël e ujit trajtohet për përdorim si ujë i pijshëm.

15 Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017 - 2036

16 Raportet mjedisore mujore dhe vjetore të KEK-ut 2009-2019

Uji industrial përdoret kryesisht për ftohjen e furrave elektrike, granulimin e skories, prodhimin e avullit dhe për sistemet e pastrimit të gazrave dhe pluhurit të konvertorët dhe furrat elektrike. Pjesa më e madhe e ujit industrial pas ftohjes në kullat ftohëse riqarkullohet, dhe shpenzimi më i madh i ujit është gjatë procesit të avullimit (kullat ftohëse, granulimi i skories).

Sipas të dhënave NewCo Feronikeli, gjatë vitit 2019 janë shfrytëzuar rreth 1.5 milion m<sup>3</sup> ujë, që shënon një ngritje përafërsisht me 0.16 milion m<sup>3</sup> ujë me vitin paraprak. (shih Figuren 20).




Figura 20. Sasia e ujit të shpenzuar ne NewCo Feronikel, 2009-2019<sup>17</sup>

Sharrcem, fabrika e çimentos Sharrcem në Han te Elezit operon me një sistem të mbyllur të shfrytëzimit të ujit në të gjitha pikat e procesit të prodhimit. Ky sistem furnizohet me ujë nga burimet e lumit Lepenci dhe sistemit të ujës-jellës nga përroi i Dimcës. Sasia e ujit që shpenzohet në këtë operatorë përfshinë: kondicionimin e gazrave të furrës, procesi i ftohjes në kullën koncionuese dhe shpenzimi për çështje sanitare.

Sipas të dhënave nga Fabrika e çimentos SharrCem shpenzimi i ujit për vitin 2019 ishte rreth 103 mijë m<sup>3</sup> ujë, që shënon rënie në krahasim me vitin paraprak ku ishin shpenzuar rreth 175 mijë m<sup>3</sup> ujë (shih Figuren 21).




Figura 21. Sasia e ujit të shpenzuar në Sharrcem, 2009-2019<sup>18</sup>

#### 4.4. Shfrytëzimi i ujërave për hidroenergjetikë

Dihet se vendi jonë ka kapacitete të plota për prodhim të energjisë. Pas KEK-ut që është burimi kryesor i prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike, faktor tjetër po aq i rëndësishëm janë hidrocentralet. Ndërtimi, jetëgjatësia dhe funksionimi i tyre paraqesin një element me rëndësi në shfrytëzimin e resurseve ujore.

Shumica e hidrocentraleve kanë një jetëgjatësi 25 vite. Ndërsa zhvillimi i një programi për aktivizimin e këtyre hidrocentraleve është pjesë e politikës energjetike të strategjisë së energjisë së Kosovës.

Aktualisht në vendin tonë funksionojnë 7 hidrocentrale të cilat janë aktive si dhe 12 janë në ndërtim e sipër. Vlenë të theksohet se në vitin 2018 nuk është dhënë asnjë leje për ndërtim të hidrocentraleve nga MMPH. Kapaciteti i hidrocentraleve aktive është 36.6MW (shih Tabelen 10). 12 hidrocentrale janë në fazën e ndërtimit (shih Tabelen 11).

Tabela 10. Hidrocentralet aktive në Kosovë

Nr.	Hidrocentrali	Vendi	Lumi	Kapaciteti	Afati
1	“Eurokos JH&Loreto consult AG”	Dragash	Brod 2	1.25MË	20 vite
2	“Frigo Food Energy Invest”	Dikanc	Dikanc	2.50 MË	5 vite
3	“Kelkos Energy”	Deçan	Lumbardhi i Deçanit I (penda)	5.50 MË	5 vite
4	“Hydro-Line”	Albaniku I Mitrovicë	Lumi Bistrica	6.80 MË	20 vite
5	“Hydro-Line”	Albaniku II Mitrovicë	Lumi Bistrica	9.85 MË	20 vite
6	“Hydro-Line”	Albaniku III Mitrovicë	Lumi Bistrica	9.90 MË	20 vite
7	“Triangle General Contractors.INC”	Radavc	Burimi i Radavcit	0.80 MË	-

Tabela 11. Hidrocentralet në fazën e ndërtimit

Nr.	Hidrocentrali	Vendi	Lumi	Kapaciteti	Afati
1	“Eurokos JH&Loreto consult AG”	Dragash	Brod 1	1.06 MË	20 vite
2	“Eurokos JH&Loreto consult AG”	Dragash	Brod 3	3.12 MË	20 vite
3	“Kelkos Energy”	Deçan	Lumbardhi i Deçanit	9.30 MË	15 vite
4	“Kelkos Energy”	Deçan	Lumbardhi i Deçanit	8.40 MË	15 vite
5	“Eurokos JH&Loreto consult AG”	Dragash	Lumi Restelica 2	1.20 MË	20 vite
6	“Drini i Bardhë”	Dobrushë	Lumi Dobrushë	9.90 MË	20 vite
7	“Eurokos JH&Loreto consult AG”	Dragash	Lumi Restelica 1	1.20 MË	20 vite
8	“Eurokos JH&Loreto consult AG”	Dragash	Lumi Restelica 3	1.498 MË	20 vite
9	“Hydro-Line”	Albaniku IV Mitrovicë	Lumi Bistrica	6.20 MË	20 vite

10	“Edelweis Energy”	Ura e shenjët	Lumi Drini i Bardhë	6.50 MË	20 vite
11	“Hydroenergy”	Lepenc 1	Lumi Lepenc	10 MË	20 vite
12	“Hydroenergy”	Lepenc 3	Lumi Lepenc	8.50 MË	20 vite

#### 4.5. Shfrytëzimi i ujërave për rekreacion

Burimet ujore në Kosovë shfrytëzohen edhe për rekreacion dhe pushime. Burimet e ujërave termomineral, akumulacionet ujore, lumenjë dhe liqenet për çdo vitë shfrytëzohen nga pushues të shumtë për pushime dhe rekreacion. Nga shumë biznese në gjithë vendi janë të ndërtuar me dhjetra mini-pishina të cilat frekuentohen nga shumë pushues për cdo sezon verore. Me që këto objekte janë të regjistruara si objekte sportive dhe rekreative, dhe nuk ka ndarja të veçantë vetëm për pishina, numri i tyre në përgjithësi është 199 të regjistruar si pishina, objekte sportive etj). Këto objekte sportive për rekreacion janë të shtrirë në 28 komuna të Kosovës (shih Tabelen.12).

Tabela 12. Objektet të destinuar për rekreacion

Nr.	Deçan	Dragash	Ferizaj	F.Kosovë	Gjakovë	Gjilan	Drenas	H. i Elezit	Istog	Kaçanik	Kamenicë	Leposaviç	Kline	Lipjan	Malishevë	Mitrovicë	Obiliq	Pejë	Podujev	Prishtinë	Prizren	Rahovec	Shterpc	Shitme	Skenderaj	Suharekë	Viti	Vushtrri
Objektet sportive 3 rekreacion	3	1	16	4	9	5	4	1	3	8	1	1	3	7	1	9	1	11	8	35	12	6	1	6	5	5	6	6

## 5. MONITORIMI I UJËRAVE

### 5.1. Monitorimi i ujërave sipërfaqësore

Monitorimin e ujërave të lumenjëve në territorin e Republikës së Kosovës e bënë Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Cilësia e këtyre lumenjëve përcaktohet në bazë të analizave fizike- kimike dhe metaleve të rënda. Rrjeti i monitorimit ka gjithsej 54 vend-monitorime (stacione monitorues). Parametrat fizik që aktualisht janë 10 (maten 11 herë në vit), 39 parametra kimik (maten 11 herë në vit) dhe 8 metale të rënda (2 herë në vit).

Listën e plotë të parametrave që monitorohen nga IHMK e gjeni në Aneksin 3 të këtij raporti.

Pellgu i Drinit të Bardhë përfshin 10 lumenj me 23 stacione monitoruese (10 stacione janë referente dhe monitorohen 2 herë në vit, ndërsa 13 janë stacione për gjatë rrjedhjes së lumenjve dhe monitorohen 11 herë në vit).

Pellgu i Ibrit përfshin 7 lumenj me 18 stacione monitoruese (5 stacione janë referente dhe monitorohen 2 herë në vit, ndërsa 13 janë stacione përgjatë rrjedhjes së lumenjve dhe monitorohen 11 herë në vit).

Pellgu i Moravës së Binçës përfshin 2 lumenj me 6 stacione monitoruese (2 stacione janë referente që monitorohen 2 herë në vit, ndërsa 4 janë stacione përgjatë rrjedhjes së lumenjve dhe monitorohen 11 herë në vit).

Pellgu i Lepencit përfshin 2 lumenj me 7 stacione monitoruese (2 stacione janë referente dhe monitorohen 2 herë në vit, ndërsa 13 janë stacione përgjatë rrjedhjes së lumenjve dhe monitorohen 11 herë në vit).

Kodet e stacioneve monitoruese dhe lokacionet e tyre janë të prezantuara në Aneksin 4 të raportit. Ndërsa në hartën vijuese është prezantuar shpërndarja hapësinore e lokacioneve të stacioneve monitoruese në lumenjtë e Kosovës. ( shih Figuren.22).




Figura 22: Stacionet e monitorimit të cilësisë së ujërave të lumenjëve

### 5.1.1. Pellgu i Drinit të Bardhë

Ky pellg ka sipërfaqe më të madhe se sa pellgjet e lumenjëve të tjerë të vendit tonë. Rrjeti i monitorimit të këtij pellgu ka 23 stacione monitorimi të cilësisë fiziko-kimike, 3 nga këto stacione janë bazë të cilat i takojnë vetë lumit Drini i Bardhë duke filluar nga burimi i tij në bjeshkën e Radavcit në Pejë, pastaj stacioni tjetër monitorues i radhës është pas puçitjes së lumenjëve në Istog dhe lumit Klina në afërsi të qytetit të Klinës dhe stacioni i tretë i këtij lumi është vendosur pas puçitjes së lumenjve Lumëbardhi i Pejës dhe Deçanit, lumit Mirushë, Erenik, Rimnik dhe Toplluhë ndërsa vendndodhja e këtij stacioni është tek ura mbi lum në vendbanimin Gjonaj të Hasit. Cilësia e ujit përgjatë rrjedhës së tij ndryshon nga stacioni në stacion sepse në burim ka cilësi tejet të mirë dhe pastaj në dy stacionet tjera ka ndotje që vijnë nga ujërat e pa trajtuara të cilat derdhen në të dhe në lumenjtë e cekur më lartë që janë nënpellgje të këtij lumi, po ashtu ndotja vjen edhe nga ujërat që bëjnë shpëlarjen e tokave bujqësore.

Të dhënat e analizave fizik-kimike për këto gjashtë vjetët e fundit, tregojnë që këto në të gjitha burimet e lumenjve uji është i cilësisë së mirë. Ndryshimi i gjendjes fillon për rreth vendbanimeve me shkarkimin e ujërave të ndotur, shkarkimet e ujërave nga kolektorët e industrive përgjatë rrjedhës së këtij pellgu lumor. Po ashtu shkaktar i kësaj ndotje është edhe hedhja e mbeturinave sidomos në vendet e pozicionimit të urave e edhe gjetkë. Deri te pika e bashkimit me lumin Istog uji kryesisht është i cilësisë së mirë. Ndryshimet drastike fillojnë në rajonin Zllakuqan–Ruhot dhe Zllakuqan–Klinë. Te pika e puçitjes së Drinit të Bardhë me lumin Klina bëhet përkeqësimi i gjendjes së tij, sepse rezultatet tregojnë për një kualitet jo të mirë të ujit. Pra uji i pellgut Drini i Bardhë ndotet nga shkarkimet e nënpellgjeve të cilat paraprakisht u janë nënshtuar ndikimeve njerëzore. Kjo gjendje vazhdon gjerë në Vllashnje, tek pika e shkarkimit të Lumëbardhit të Prizrenit.

**Lumi i Istogut në Istog** buron në bjeshkën mbi qytetin e Istogut me një pastërti të madhe me cilësi shumë të mirë dhe në krahasim me lumenjtë e tjerë ky lum deri në puçitje të tij në Drinin e Bardhë nuk pëson ndryshime të mëdha në cilësi, prandaj dhe nga monitorimi i gjertanishëm njihet si lumi më i pastër në Kosovë.

**Lumi Klina**, stacioni i parë monitorues ndodhet në Kuqicë, i cili nuk i plotëson kriteret e të ashtuquajturës burim i parë ose kryesor sepse ai ndodhet larg këtij lokaliteti prandaj deri në këtë vendndodhje aktiviteti njerëzor është mjaft i shprehur. Për këtë arsye dhe cilësia e tij është mjaftë e dobët në të dy stacionet monitoruese gjë që jep të kuptohet edhe nga rezultatet e analizave laboratorike të paraqitura në figura.

**Lumëbardhi i Pejës - Bistrica e Pejës** formohet nga disa burim përgjatë Grykës së Rugovës të cilat burime në stacionin e parë monitorues në Haxhaj kanë cilësi fiziko-kimike të mirë, përderisa kjo cilësi në stacionin tjetër pas shkarkimeve të ujërave të ndotura urbane dhe industriale pëson ndryshim, për faktin se gjatë stinës së verës në sezonin e ujitjes së tokave bujqësore ky lum shtëron për një periudhë përafërsisht dymujore. Stacioni i tretë



monitorues është në afërsi të Klinës para puçitjes me lumin e Drinit të Bardhë ku cilësia e tij është më e dobët.

**Lumi Mirusha** formohet në kodrinat mbi fshatin Bllacë të Therandës nga shumë burime të vogla, në fshatin Banjë e Malishevës burimi i ujit që buron në bazenin e fshatit merret si pikë referente ku dhe ky lum merr formën e plot të lumit dhe prej aty i shtohet edhe ujërrjedha e burimit të fuqishëm sipërfaqësorë që njihet me emrin Uligja e Banjës. Ky lum monitorohet në dy stacione ku para puçitjes me lumin Drini i Bardhë cilësia e tij karakterizohet me turbullirë të vogël, pra i takon ujërave të lumenjvëe me cilësi mesatare.

**Lumëbardhi i Deçanit - Bistrica e Deçanit**, stacioni i parë i monitorimit sipas rrjetit të IHMK gjendet në km e 3 mbi qytetin e Deçanit mbi kishë ku cilësia e tij është shumë e mirë, stacioni tjetër ndodhet 10 m para puçitjes me lumin Drini i Bardhë në fshatin Kralan të Gjakovës, cilësia e tij në këtë stacion nuk është edhe aq alarmuese por ka ngritje të vlerave të parametrave në krahasim me stacionin e parë edhe në këtë lumë shkaktohet turbullirë e madhe për shkak të nxjerrjes së zhavorrit nga shtrati i tij prej kompanive private vetëm disa dhjetëra metra mbi stacionin e monitorimit të këtij lumi.

**Lumi Ereniku**, stacioni i parë i monitorimit të cilësisë së ujit të këtij lumi ndodhet në bjeshkët mbi fshatin Jasiq (KK Junik) aty ku nuk ka influencë nga aktivitetet njerëzore, cilësia e ujit rezulton shumë e mirë. Stacioni i dytë sipas rrjetit të monitorimit është afër puçitjes me lumin e Drinit të Bardhë në afërsi të Gjakovës te Ura e Terzive, cilësia e ujit të këtij lumi në këtë stacion është e dobët, meqenëse gjatë analizave është vërejtur prezenca e sasisë së detergjenteve. Si pasojë i kësaj lumi gjithnjë ka shkumë mbi sipërfaqe që supozohet të jetë rezultat i ndonjë veprimtarie për larjen e tekstileve (rrobave), autolarjeve apo edhe të ndonjë përdorimi tjetër të detergjenteve nga industritë të cilat veprojnë në atë regjion dhe që ujërat e tyre i shkarkojnë pa trajtim paraprak.

**Lumi Rimniku**, monitorimi i tij fillon në vendin e quajtur Zhdrellë jo larg nga burimi i tij, njihet si burim me përçueshmëri më të lartë (~780  $\mu\text{S}/\text{cm}$ ) se të gjitha burimet e tjera. Stacioni i radhës është disa metra para puçitjes me lumin Drini i Bardhë në Xërxë i cili ka sasi të vogël të oksigjenit dhe sasi të madhe të jonit amonium, fosfateve etj.

**Lumi Toplluha**, stacion fillestar për monitorimin e këtij lumi është në vendin e quajtur Buqallë mbi kompleksin turistik “SOLID” e Suharekës, uji i këtij lumi ka cilësi shumë të mirë në të gjithë parametrat e matur, përderisa në stacionin e dytë në fshatin Piranë disa dhjetëra metra para puçitjes me lumin e Drinit të Bardhë uji ka cilësi më të dobët, njihet si lumi permanent me turbullirë të lartë për shkak të nxjerrjes së zhavorrit nga shtrati i lumit pothuajse në kontinuitet gjatë gjithë vitit.

**Lumëbardhi i Prizrenit - Bistrica e Prizrenit** fillon nga Prevalla ka rrjedhë rrekë, stacioni i parë monitorues ndodhet po në grykën e Prevallës dhe ka cilësi mjaftë të mirë në të gjitha aspektet. Stacioni i dytë në rrjetë është në fshatin Vllashnje 3,5 km para puçitjes me lumin e Drinit të Bardhë dhe nëse e krahasojmë cilësinë e ujit të tij me stacionin e parë monitorues do të vërejmë një ndryshim të madh në cilësinë e tij për shkak të shkarkimit të të gjitha ujërave të ndotura në të përgjatë rrjedhës së tij.

### 5.1.2. Pellgu i Ibrit

Pellgu i Ibrit ka gjithsejtë 18 stacione monitorimi, tri nga to janë stacione që i takojnë lumit Ibër, stacioni i parë është në Kushtovë dhe cilësia e tij është e kënaqshme, stacioni i radhës është në dalje të qytetit pas të gjitha shkarkimeve të ujërave urbane e të tjera, të cilat ndikojnë që cilësia e ujit të jetë më e dobët në këtë stacion, stacioni i tretë ndodhet në Kelmend pas puçitjes së tij me lumin Sitnica i cili paraprakisht me vete përmban gjithë sasinë e ujërave të nënpellgjeve të këtij pellgu lumor. Gjatë kësaj periudhe monitoruese nuk është vërejtur ndonjë rast për tu alarmuar.

**Lumi Sitnicë**, duke filluar prej Ferizajt deri në Mitrovicë është lumi më i ndotur në Kosovë. Sa i përket parametrave fizik si: materiet e suspenduara janë prezent dhe i tejkalojnë vlerave maksimale të lejuara. Kjo vjen nga ajo se në këtë lum derdhet njëra pjesë e lumit të Nerodimës dhe lumenjtë Shtime, Graçanka, Prishtevka, Drenica, Llapi, Trepça si dhe ujërrjedha tjera më të vogla ku të gjitha këto puçiten në lumin Sitnicë, përmbajnë në vete ujërat e shkarkimeve të amvisëri si dhe ujërat e shkarkimeve industriale. Sa i përket parametrave kimik duke u bazuar në matjet e bëra siç janë sasia e oksigjenit të tretur dhe  $SHBO_5$  si indikator që tregojnë për ndotjen permanente të këtij lumi.

**Llapi**, monitorimi i këtij lumi bëhet që nga burimi i tij mbi fshatin Marincë dhe vazhdon pastaj stacioni i dytë në Podujevë në dalje të qytetit dhe stacioni i tretë dhe i fundit në Lumadh para puçitjes së tij me lumin Sitnicë dhe nuk ka tejkalim të VML.

**Prishtevka**, monitorimi i këtij lumi bëhet në Bresje të Fushë Kosovës para derdhjes së tij në lumin e Sitnicës. Ky lum konsiderohet si ndër më të ndoturit në Kosovë sepse është kolektori i të gjitha ujërave të shkarkuara urbane të Prishtinës. Gjithashtu ka tejkalim të vlerave të lejuara për nitrite, materie te suspenduara, shpenzimi kimik dhe biokimik te oksigjenit, mungesë të oksigjenit të tretur, detergjente etj.

**Graçanka**, cilësia e ujit të këtij lumi është në vazhdimësi e ndotur si rezultat i pompimit të ujërave nga minierat e Kizhnicës dhe Artanës poashtu edhe shkarkimet e disa vendbanimeve përgjatë rrjedhës së tij. Ka vlera të larta të përqeshmërisë elektrike dhe të jonit sulfat. Vlen të ceket se gjatë stinës së ngrohtë të verës ky lum shtëron.

**Drenica**, monitorimi i këtij lumi bëhet duke filluar nga Pjetërshtica, stacioni i dytë është

vendos në Drenas pas shkarkimeve urbane si dhe vendmostrimi i tretë para bashkimit me Sitnicën në Vragoli. Gjatë stinës së pranverës në stacionin e parë monitorues ka një cilësi të mirë përderisa në stacionin e dytë në Drenas cilësia e tij është me ndotje permanente e në të tretin në Vragoli gjendja e tij pëson ndryshime edhe më të theksuara p.sh. përçueshmëria elektrike rritet për disa qindra njësi si rezultat i shkarkimeve të ujërat nga Ferronikeli si dhe ujrave të pompuara të mihjeve sipërfaqësore të KEK-ut.

**Shtimja**, ka dy stacione monitorimi njëhën në pjesën ku nuk ka ndikim të jashtëm nga aktivitetet njerëzore dhe se cilësia e tij është shumë e mirë dhe stacioni i dytë është pas shkarkimeve të të gjitha ujërave urbane nga të gjitha fshatrat për rreth si dhe të vetë qytetit të Shtimes prej nga cilësia e ujit të këtij lumi kalon në kategorinë më të dobët.

### 5.1.3. Pellgu i Morvës së Binçës dhe Lepencit

**Morava e Binçës**, monitorimi i këtij lumi bëhet duke filluar nga fshati Korbulliq, pastaj në fshatin Kllokot, Ranilugë si dhe në kufirin me Serbinë në Domoroc ku dhe në këtë fshat bashkohet me lumin Kriva Reka të Dardanës. Në këtë lum po ashtu shkarkohen të gjithë ujërat urbane dhe industriale të Vitisë, Gjiljanit dhe Dardanës.

**Lumi Kriva Reka**, ky lum ngërthen në vete dy stacione monitorimi ku uji në stacionin e parë të monitorimit rezulton me cilësi të lartë, përderisa në fshatin Marevc ku bëhet shkarkimi i ujërave të minierës së Artanës në këtë lum atëherë ndotja është me përmasa të larta; si në uljen e vlerës së pH, poashtu edhe në rritjen e koncentrimëve të disa metaleve të rënda. Si rezultat i kësaj gjatë precipitimit të tyre shkaktohet turbullira dhe shtresim të tyre në fund të shtratit të lumit prej nga dhe shtrati i tij ka marrë ngjyre të kaftë, pastaj gjatë rrjedhjes kjo sasi e metaleve si rezultati i rritjes së vlerës së pH eliminohet. Në stacionin e dytë në Domoroc cilësia e ujit është jo e mirë ku parametrat që e rezultojnë më ndotje më të lartë janë: turbullira, amoniaku si dhe nitritet.

**Lumi Lepenc**, ky lum ka dy burime njëri në Bjeshkën e Prevallës e tjetri në Bjeshkën e Brezovicës. Që të dy kanë cilësi shumë të mirë të ujërave. Kjo gjendje vazhdon deri në shkarkimin e ujërave të fabrikës “Silkapor” ku ujin herë pas here turbullohet si rezultat i shkarkimeve të ujërave nga shpëlarja e lëndës së parë që përdor fabrika. Kjo dukuri vazhdon për disa km, dhe është prezent edhe në stacionin e dytë të monitorimit të këtij lumi i cili ndodhet në Kaçanik para puçitjes së Lepecit me lumin Nerodimje. Pas bashkimit me këtë lum matja bëhet në stacionin e tretë në Han të Elezit, i cili është stacion ndërkufitarë me Republikën e Maqedonisë së Veriut. Cilësia e tij është brenda kufijve të lejueshëm.

**Lumi Nerodime**, ky lum fillon në bjeshkët e Jezercës komuna e Ferizajt me një cilësi të lartë të ujit, ndërsa në stacionin e dytë në fshatin Gërlicë pas shkarkimeve të ujërave urbane dhe të ujërave të tjera të regjionit të Ferizajt cilësia e ujit të këtij lumi bie duke vazhduar edhe në stacionin e radhës në Kaçanik para bashkimit të tij me lumin Lepenc.

## 5.2. Vlerësimi i gjendjes dhe rezultateve te monitorimit

### 5.2.1 Pellgu i Drinit të Bardhë

Për interpretimin e gjendjes së nën pellgjeve të lumit Drini i Bardhë, vlen e njëjta pasqyrë e ndryshueshmërisë në hyrje dhe dalje të tyre. Në vijim me anë të figurave do të paraqesim një interpretim të vlerave mesatare vjetore (VMV<sup>19</sup>) të secilit parametër në secilin stacion të secilit lum të këtij pellgu.

**Sasia e oksigjenit të tretur (O<sub>2</sub> tretur)**- në vazhdimësi qëndron në vlera të konsiderueshme gjatë rrjedhës së këtij lumi (pellgu). Viti 2014 tregon një vlerë mesatare për oksigjenin e tretur 8.7 mg/l. Në vitin 2015 kemi minimumin e vlerës 6.36 mg/l dhe maksimumin 8.96 mg/l . Viti 2016 paraqitet me një minimum të oksigjenit të tretur 4.99 mg/l dhe maksimum të vlerës mesatare vjetore 8.38 mg/l. Viti 2017 paraqitet me një minimum të oksigjenit të tretur 5.25 mg/l dhe maksimum të vlerës mesatare vjetore 9.71 mg/l. Viti 2018 paraqitet me një minimum të oksigjenit të tretur 5.8 mg/l dhe maksimum të vlerës mesatare vjetore 9.54 mg/l. Pothuajse e njëjta situatë është edhe për vitin 2019 me një minimum të oksigjenit të tretur 5.97 mg/l dhe maksimum të vlerës mesatare vjetore 9.10 mg/l (Figurën.23).




Figura 23: Oksigjeni i tretur në pellgun e Drinit të Bardhë mg/l

**Shpenzimi biokimik i oksigjenit (SHBO<sub>5</sub>)**- viti 2014 paraqitet me vlerë mesatare maksimale 13.55 mg/l, ndërsa për vitet 2015 dhe 2016 tregohet një rritje e vlerës mesatare maksimale 16.53 mg/l. Për vitin 2017 gjendja paraqitet me një situatë më të përmirësuar me 9.90 mg/l. Ndërsa për vitet 2018 dhe 2019 parametri shpenzimi biokimik i oksigjenit, paraqitet me vlerë mesatare maksimale 22.75 mg/l.

Nëse krahasojmë vlerat mesatare vjetore me vlerat e matjeve serike vërehet se SHBO<sub>5</sub> gjendet edhe në vlera më të larta së këto ( shih Figuren.24).

19

VMV- nga vlerat serike mujore janë llogaritur vlerat mesatare vjetore.




Figura 24: Shpenzimi biokimik i oksigjenit në pellgun e Drinit të Bardhë mg/l

Sa i përket cilësisë, në bazë të dhënave nuk ka ndotje të theksuar në asnjë nga stacionet monitoruese.

**Përçueshmëria elektrike (PE)**– në të gjitha vitet: 2014, 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019 vlerën më të ulët e shënon lumi Lumëbardhi i Prizrenit- Prevallë 92  $\mu\text{s/cm}$ , 65  $\mu\text{s/cm}$ , 103  $\mu\text{s/cm}$ , 106  $\mu\text{s/cm}$ , 83  $\mu\text{s/cm}$  dhe 81  $\mu\text{s/cm}$  ndërsa për vitin 2014, 2015 dhe 2016 vlera më e lartë është në lumin Rimmnik- Xërxë me vlera 713  $\mu\text{s/cm}$ , 740  $\mu\text{s/cm}$  dhe 780  $\mu\text{s/cm}$ ; vitin 2017 vlerë maksimale shënohet në të njëjtin lum Rimmnik por në vend-mostrimin Zhdrellë 695  $\mu\text{s/cm}$ , derisa për vitin 2019 vlera maksimale mesatare vjetore shënohet në lumin Klina vend-mostrimi Klinë 627  $\mu\text{s/cm}$  (shih Figuren.25).




Figura 25: Përçueshmëria elektrike në pellgun e Drinit të Bardhë

**Përqëndrimi i jonit hidrogjen (pH)**- Në vitin 2014 vlerë të ulët të pH tregon lumi Klina-Stërnac i Ulët 7.13, derisa maksimumi për këtë vit është në lumin Rimnik- Zhdrellë 8.04. Viti 2015 tregon një zgjerim intervali të vlerës së pH, me vlerën më të ulët në lumin Mirusha – Banjë e Malishevës 7.30 derisa maksimumin e kësaj vlere e tregon lumi Rimnik- Zhdrellë me vlerë 8.18. Derisa në vitin 2016 vlerën më të ulët pH shënon në lumin Mirusha– Banjë e Malishevës 7.26 derisa maksimumin e vlerës mesatare vjetore e shënon lumi Toplluha-Buqallë me vlerë të pH-së 8.48.

Në vitet 2017, 2018 dhe 2019 vlerë më të ulët të pH-së paraqet lumi Mirusha– Banjë e Malishevës 7.15, 7.12 dhe 7.21 derisa maksimumi i vlerës së pH-së për vitin 2017 paraqitet në lumin Lumëbardhi i Deçanit- Kralan 8.33, së për vitin 2018 paraqitet në lumin Lumëbardhi i Pejës- Pejë Dalje 8.13 dhe për vitin 2019 vlera maksimale e pH me vlerë të njëjtë paraqitet në dy stacione monitoruese 8.13 lumi Drini i Bardhë – Gjonaj dhe në lumin Klina- Stërnac i Ulët (shih Figuren.26).




Figura 26: Përqëndrimi i jonit hidrogjen në pellgun e Drinit të Bardhë

**Azoti i nitrateve (N-NO<sub>3</sub><sup>-</sup>)**- Në të gjitha vitet, pothuajse në të gjitha stacionet e vend - burimeve, parametri azoti i nitrateve paraqitet si limit i kuantifikimit. Maksimumi i vlerës mesatare vjetore për vitet 2014, 2015, 2016 dhe 2018 paraqitet në lumin Toplluha- Piranë me vlera 2.402 mg/l, 2.307 mg/l, 2.31 mg/l dhe 2.402 mg/l. Ndërsa maksimumi i vlerës mesatare për vitin 2017 është në lumin Klina- Kuqicë 2.061 mg/l dhe në vitin 2019 lumi Mirusha- Volljakë shënon ngritje të theksuar me vlerë mesatare vjetore 2.398 mg/l (shih Figuren.27).




Figura 27: Azoti i nitraveve në pellgun e Drinit të Bardhë

**Azoti i nitraveve (N-NO<sub>2</sub>-)**- edhe për azotin e nitraveve, sikurse tek azoti i nitraveve, për të gjitha vitet pothuajse në të gjitha stacionet e vend-burimeve vlerat matëse paraqitet si limit i kuantifikimit.

Vlera maksimale të mesatares vjetore për gjashtë vitet 2014-2019 paraqiten në lumin Rimmik- Zhdrellë me vlera që sillen nga 0.134 – 0.222 mg/l (shih Figuren.28).




Figura 28: Azoti i nitraveve në pellgun e Drinit të Bardhë mg/l

**Azoti i amoniumit ( $\text{N-NH}_4^+$ )-** në vitin 2016 lumi Lumbardhi i Pejës- Drelaj minimumi i VMV është 0.157 mg/l, viti 2017 në lumin Lumbardhi i Prizrenit- Prevallë minimumi i VMV është 0.157 mg/l, viti 2018 në lumin Klina- Stërnac i Ulët minimumi i VMV është 0.544 mg/l dhe viti 2019 minimumi i VMV është 0.105 mg/l. Përderisa, në vitet 2014 dhe 2015 paraqitet limiti i kuantifikimit (0.015 mg/l  $\text{N-NH}_4^+$ ) në stacionin monitorues lumi Lumbardhi i Pejës- Drelaj, përkatësisht lumi Mirusha- Banja e Malishevës.

Maksimumi i VMV për katër vitet është shënuar në lumin Rimmnik stacioni monitorues në Xërxë me vlera që sillen nga (0.169 – 3.063 mg/l $\text{N-NH}_4^+$ ). (shih Figuren.29).




Figura 29: Azoti i amoniumit në pellgun e Drinit të Bardhë mg/l

Duke u bazuar në vlerat e lejuara të cilat nuk duhet të jenë më të larta se 1.5 mg/l vërehet se përpos burimeve ku cilësia e ujëra është e mirë, në stacionet e tjera të monitorimit kjo cilësi është e nivelit mesatar dhe të ulët.

**Fosfori i ortofosfateve ( $\text{P-PO}_4^{3-}$ )-** limiti i kuantifikimit (0.003 mg/l) paraqitet tek këto stacione monitoruese: në vitin 2014, 2017, 2018 dhe 2019 lumi Drini i Bardhë- Radavc, në 2015 lumi Lumbardhi i Pejës- Drelaj, në vitin 2016 lumi Mirusha- Banja e Malishevës ka vlerë minimale mesatare vjetore 0.043 mg/l.

Ndërsa vlerë maksimale vjetore tregon lumi Rimmnik- Xërxë për të gjitha vitet (me përjashtim viti 2018 ku vlera maksimale vjetore paraqitet në lumin Lumbardhi i Prizrenit- Vllashnje 0.342 mg/l) me vlerë nga 0.297- 0.578 mg/l. (shih Figuren.30).






Figura 30: Fosfori i ortofosfateve në pellgun e Drinit të Bardhë mg/l

**Fosfori total (poli dhe orto)-** vlera e fosforit total në pellgun e Drinit të Bardhë rezulton me luhatje të mëdha. Vlera e minimumit mesatar vjetor për fosforin total për vitin 2014 është në lumin Drini i Bardhë- Gjonaj me vlerë të fosforit total 0.036 mg/l P. Për vitin 2015 vlera e minimumit mesatar vjetor për fosforin total është në lumin Lumbardhi i Pejës- Grabanicë 0.06 mg/l. Ndërsa në vitet 2016, 2017, 2018 dhe 2019 vlerat e minimumit mesatar vjetor për fosforin total sillen nga 0.003-0.091 mg/l, në stacionet monitoruese lumi Toplluha- Buqallë, lumin Lumbardhi i Prizrenit-Prevallë dhe lumi Mirusha- Banjë e Malishevës.

Derisa vlerat maksimale vjetore (VMV) në vitin 2014 paraqiten në lumin Toplluha- Piranë me vlerë 0.534 mg/l dhe në vitet tjera 2015 deri 2019 vlerat maksimale vjetore (VMV) është paraqitur në lumin Rimnik vendmostrimi Xërxë me interval vlerash nga 0.580– 1.514 mg/l (shih Figuren.31).




Figura 31: Fosfori total (poli dhe orto) në pellgun e Drinit të Bardhë mg/l

### 5.2.2. Pellgu i Ibrit

Në vijim përmes rezultateve me VMV të paraqitura në figura do të interpretohet gjendja e ujërave në pellgun e Ibrit me vlera mesatare vjetore për një numër të përzgjedhur të parametrave që maten nga IHMK në lumenj të këtij pellgu.

**Sasia e oksigjenit të tretur ( $O_2$  tretur)**- vërehet se ndryshon nga stacioni në stacion por mund të themi se në të gjitha rrjedhat e këtij pellgu ka sasi të mjaftueshme për pos në lumin e Prishtëvka në Bresje që sasia e  $O_2$  të tretur është e ultë.

Nëse krahasojmë vlerat e parametrin sasia e oksigjenit të tretur ndër vite 2014 - 2019 shihet se nuk ka ndonjë ndryshim të madh në stacionet fillestare (referente), si vlerë më e lartë e  $O_2$  të tretur është matur në lumin Ibër- Kushtovë me vlerë 10.31 mg/l. Por se përgjatë stacioneve rrjedhëse monitoruese, sasia e vlerës minimale shënohen në lumin Prishtëvka- Bresje me një vlera mesatare minimale 2014-2019 prej 3.85 mg/l. Por duhet pasur parasysh se këto janë vlera mesatare vjetore sepse ka raste, d.m.th. gjatë dinamikës mujore të monitorimit, që në këtë stacion monitorimi të mos ketë fare  $O_2$  të tretur. (shih Figuren.32).




Figura 32: Oksigjenit të tretur në pellgun e Ibrit mg/l

**Shpenzimi biokimik i oksigjenit ( $SHBO_5$ )** - krahasimin e bërë në mes vlerave në vitin 2014-2019, vërehen ndryshime të vogla çka nënkupton se edhe cilësia e ujit të këtij pellgu në vazhdimësi nga viti në vit ,pra nga sezoni në sezon është pak i ndryshueshëm. Vlerat maksimale e  $SHBO_5$  është në stacionin Bresje të lumit Prishtëvka me vlera mesatare vjetore ndër vite 29.29 mg/l -77.20 mg/l. (shih Figuren.33).




Figura 33: Shpenzimi biokimik i oksigenit në pellgun e Ibrit mg/l

**Përçueshmëria elektrike-** marrë në përgjithësi për këto gjashtë vite gjendja mbetet e njëjtë. Si vendmostrim me vlerat më të ulëta të mesatare vjetore (për vitet 2014-2019) të përçueshmërisë elektrike paraqitet lumi Ibër- Kushtovë me interval vlerash (257  $\mu\text{s/cm}$  -305  $\mu\text{s/cm}$ ). Në vitin 2018 minimumi i vlerës mesatare paraqitet në lumin Shtime-Devetak me vlerë 152  $\mu\text{s/cm}$ . Ndërsa si vend-mostrim me vlerat më të larta të mesatares vjetore (për katër vitet) paraqiten te lumi Graçanka- Vragoli me interval vlerash (1114  $\mu\text{s/cm}$  - 1529  $\mu\text{s/cm}$ ) (shih Figurën.34).




Figura 34: Përçueshmëria elektrike në pellgun e Ibrit

**Përqendrimi i jonit hidrogjen (pH)**- vlerat e pH për vitin 2014 sillen zakonisht ndërmjet 7.36- 8.28, për vitin 2015 vlerat e pH sillen nga 7.93 – 8.43. Në vitin 2016 vlerat e pH sillen nga 7.89 – 8.34. Situatë e njëjtë është për dy vitet 2017-2018 vlerat e pH sillen nga 7.64 – 8.2. Edhe në vitin 2019 vlera e pH mbetet pothuajse e njëjtë 7.16-8.14 (shih Figuren.35). Thënë përgjithësisht këto ujëra i takojnë një meseri të dobët bazik.




Figura 35: Përqëndrimi i jonit hidrogjen në pellgun e Ibrit

**Azoti i nitrateve (N-NO<sub>3</sub><sup>-</sup>)**- në vendburimet e lumenjëve kryesisht paraqiten limitet e kuantifikimit ( 0.3 mg/l). (Fig.36).




Figura 36: Azoti i nitrateve në pellgun e Ibrit mg/l

Maksimumet e vlerave mesatare vjetore të parametrin azoti i nitrateve, në të gjitha vitet 2014-2019 në lumin Drenica- Vragoli, paraqitet me interval vlerash 2.203 mg/l deri 2.755 mg/l.

**Azoti i nitriteve (N-NO<sub>2</sub><sup>-</sup>)-** lumi Llap vend-mostrimi Podujevë në vitin 2014 paraqitet me maksimum të VMV 0.187 mg/l; në vitet 2015 dhe 2016 në lumin Graçanka- Vragoli maksimum të VMV me vlerë 0.270 mg/l përkatësisht 0.191 mg/l; në vitet 2017 dhe 2018 vlera maksimale të VMV paraqiten në lumin Graçanka- Vragoli 0.142 mg/l – 0.150 mg/l. Ndërsa në vitin 2019 përsëri është lumi Sinica por vendmostrimi Vragoli ku kemi vlerën maksimale të mesatares vjetore 0.180 mg/l. (shih Figuren.37).

Nga e gjitha kjo nënkuptohet për një cilësi të dobët në lumenjtë Graçanka dhe Sitnica.




Figura 37: Azoti i nitriteve në pellgun e Ibrit mg/l

**Azoti i amoniumit (N-NH<sub>4</sub><sup>+</sup>)** - tek ky parametër stacioni Bresje në lumin Prishtevka tregon vlera më të larta të këtij parametri, se sa stacionet e tjera të monitorimit të lumenjëve të këtij pellgu (shih Figuren.38).




Figura 38: Azoti i amoniakut në pellgun e Ibrit mg/l

Ku edhe për vitin 2019 gjendja paraqitet e njëjtë: në lumin Prishtevka- Bresje maksimumi i VMV është 3.105 mg/l, derisa minimumi i VMV paraqitet në vendburimet e lumenjëve.

**Fosfori i ortofosfateve (P-PO<sub>4</sub><sup>3-</sup>)** - Në tri vitet 2014 minimumi i VMV paraqitet në lumin Drini i Bardhë- Radavc me vlera nga 0.019 mg/l, në vitin 2015, 2017 dhe 2019 minimumi i VMV paraqitet në lumin Drenicë- Pjetërshticë me vlera nga 0.016 mg/l - 0.041 mg/l. Në vitet 2016 dhe 2018 si vlerë minimale e VMV paraqitet në lumin Llap- Marincë 0.049 mg/l përkatësisht 0.016 mg/l. Derisa maksimumi i VMV për të gjitha vitet paraqitet në lumin Prishtevka- Bresje nga vlera 0.619 mg/l deri 1.054 mg/l (shih Figuren.39).




Figura 39: Fosfori i ortofosfateve në pellgun e Ibrit mg/l

**Fosfori total (poli dhe orto)**- ky parametër sikurse është paraqitur edhe në figurë, lumi Prishtevka- Bresje për vitet 2014-2019, paraqitet me vlera maksimale të mesatares vjetore (VMV) më të larta 0.921 mg/l – 5.495 mg/l. (shih Figuren.40).




Figura 40: Fosfori total (poli dhe orto) në pellgun e Ibrit mg/l

### 5.2.3. Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit

Interpretimin e gjendjes së nën pellgjeve të lumit Moravë e Binçës dhe Lepenc do ta paraqesim në vijim me anë të figurave me vlera mesatare vjetore të secilit parametër në secilin lum të këtyre pellgjeve.

**Sasia e oksigjenit të tretur ( $O_2$  tretur)**- nga grafiku vihet re tendencë në ulje të vlerave të oksigjenit të tretur në stacionet pas shkarkimit të kolektorëve të ujërave të ndotura urbane. Në rrjedhjen e sipërme ujërat janë të pastër dhe të pasur me oksigjen. Varfërimi i lumenjve me oksigjen është pasojë e konsumit të tij pas shkarkimit të lëndëve organike, burimi kryesor i të cilave janë shkarkimet urbane (shih Figuren.41).




Figura 41: Oksigjenit të tretur (mg/l) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës

Uji i lumit Morava e Binçës - Ranilugë për vitet 2014, 2015, 2018 dhe 2019 rezulton me sasi më të vogël të parametrin oksigjen i tretur (me vlera nga 4.97 mg/l deri 7.15 mg/l), ndërsa uji i lumit Nerodimja- Gërllicë për vitet 2016 dhe 2017 rezulton me sasi më të vogël të parametrin oksigjen i tretur me vlerë 4.97 mg/l përkatësisht 5.36 mg/l; e gjithë kjo si pasojë e shkarkimeve të ujërave urbane dhe industriale të pa trajtuara paraprakisht.

Përderisa, maksimumi i VMV është matur në lumin Kriva- Reka - Marec, për vitin 2015 me vlerë 8.54 mg/l; për vitin 2014 maksimumi i VMV është matur në lumin Lepenc- Prevallë Subain me vlerë 10.23 mg/l; për vitin 2016 maksimumi i VMV është matur në lumin Lepenc- Hani i Elezit me vlerë 9.21 mg/l; për vitin 2017 maksimumi i VMV është matur në lumin Nerodimja- Kaçanik me vlerë 8.51 mg/l; për vitin 2018 maksimumi i VMV është matur në lumin Nerodimja- Jezerc me vlerë 9.14 mg/l. Situate e njejtë është edhe për vitin 2019, maksimumi i VMV regjistrohet në lumin Lepenc- Kaçanik me vlerë 8.87 mg/l  $O_2$ .

**Shpenzimi biokimik i oksigjenit ( $SHBO_2$ )**- Në vitin 2014 minimumi i VMV paraqitet në

lumin Nerodimja- Jezerc me vlerë 1.05 mg/l; në vitin 2015 minimumi i VMV paraqitet në lumin Morava e Binçës- Korbuliq me vlerë 4.00 mg/l; ndërsa për vitet 2016, 2017, 2018 dhe 2019 minimumi i VMV paraqitet në lumin Lepenc- Prevallë Subain me vlera nga 0.20 mg/l deri 0.53 mg/l.

Maksimumi i VMV për vitet 2014 dhe 2015 është në lumin Kriva- Reka – Domoroc me vlera nga 33.84 mg/l dhe 39.84 mg/l; në vitin 2016 maksimumi i VMV është paraqitur në lumin Nerodimja- Gërlicë me vlerë 42.40 mg/l ; në vitin 2017 maksimumi i VMV është paraqitur në lumin Morava e Binçës- Domoroc me vlerë 34.95 mg/l; ndërsa në dy vitet 2018 dhe 2019 maksimumi i VMV është paraqitur në lumin Morava e Binçës- Ranillugë me vlerë 34.45 mg/l, përkatësisht 28.6 mg/l SHBO<sub>5</sub> (shih Figuren.42).




Figura 42: Shpenzimi biokimik i oksigjenit (mg/l) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës

**Përçueshmëria elektrike** - Në të gjitha vitet prej 2014-2019 minimum të VMV është paraqitur në lumin Lepenc- Prevallë me vlera nga 20  $\mu\text{s/cm}$  deri 73  $\mu\text{s/cm}$ .

Derisa maksimumi i VMV për vitet 2014, 2015, 2017 dhe 2019 është në lumin Kriva Reka- Domoroc me vlera nga 58.3  $\mu\text{s/cm}$  deri 643  $\mu\text{s/cm}$ . Në vitin 2016 minimumi i VMV paraqitet në lumin Morava e Binçës- Ranillugë me vlerë 656  $\mu\text{s/cm}$ , ndërsa në vitin 2018 maksimumi i VMV është në lumi Lepenc- Hani i Elezit me vlerë 477  $\mu\text{s/cm}$ . (shih Figuren.43).






Figura 43: Përçueshmëria elektrike (µs/cm) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës

**Përqendrimi i jonit hidrogjen (pH)** - Në vitin 2014 vlerat e pH sillen zakonisht ndërmjet vlerave 7.29 deri 8.24; në vitin 2015 vlerat e pH sillen nga 7.79 – 8.43; në vitin 2016 vlerat e pH sillen nga 7.9 – 8.55; në vitin 2017 vlerat e pH sillen nga 7.89 – 8.35; në vitin 2018 vlerat e pH sillen nga 7.58 – 8.12; dhe në vitin 2019 vlerat e pH sillen nga 7.80 – 8.21 (shih Figuren.44).




Figura 44: Përqendrimi i jonit hidrogjen (pH) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës

**Azoti i nitrateve (N-NO<sub>3</sub>-)** - në të dy pellget në vendburime kryesisht azoti i nitriteve paraqitet me limit të kuantifikimit me vlerë (0.3 mg/l), derisa maksimumi i VMV në vitet 2014, 2016, 2017, 2018 dhe 2019 në lumin Morava e Binçës- Domorocv, me vlera nga 1.40

mg/l deri 1.785 mg/l. Ndërsa në vitin 2015 në lumin Nerodimja- Jezerc ka maksimumin e VMV prej 1.186 mg/l (shih Figuren.45).




Figura 45: Azoti i nitraveve (mg/l) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës

**Azoti i nitriteve (N-NO<sub>2</sub>)-** ky parametër në vitin 2014 në lumin Lepenc- Prevallë tregon minimumi i VMV me vlerë 0.02 mg/l; në vitin 2015 lumi Lepenc- Hani i Elezit me vlerë minimale të VMV 0.036 mg/l; viti 2017 në lumin Lepenc- Prevallë tregon minimumi i VMV me vlerë 0.016 mg/l; ndërsa në vitin 2018 në lumin Kriva Reka- Marec kemi limitit e kuantifikimit (0.009 mg/l), në vitet 2016 dhe 2019 në lumin Nerodimja – Jezerc kemi limitit e kuantifikimit (0.009 mg/l) (shih Figuren.46).




Figura 46: Azoti i nitriteve (mg/l) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës

Derisa maksimumi i VMV në vitet 2014, 2015, 2016 dhe 2017 në lumin Nerodinja-Kaçanik azoti i nitrateve paraqitet me vlera nga 0.198 mg/l, deri 0.317 mg/l, ndërsa në vitet 2018 dhe 2019 maksimumi i VMV paraqitet në lumin Morava e Binçës- Domoroc me vlerë 0.144 mg/l përkatësisht 0.167 mg/l.

**Azoti i amoniumit (N-NH<sub>4</sub><sup>+</sup>)-** Si element i ndotjes se freskët rezulton në sasi të mëdha sidomos pas kolektorëve shkarkues urbane e rurale. Amonia ku në kushte alkaline pH > 10 në mjedisin pritës sipërfaqësor ka efekte dëmtuese në faunën ujore. Prania e tij në ujëra ka efekte olfaktike me shfaqjen e erërave te pakëndshme (shih Figuren.47).




Figura 47: Azoti i amoniumit (mg/l) në pellgun e Lepencit dhe M.Binçës

Azoti i amoniumit në vitet 2014 dhe 2019 në lumin Kriva Reka- Marec paraqitet me vlera minimale e mesatares vjetore 0.102 mg/l përkatësisht 0.183 mg/l; në vitet 2015 dhe 2018 në lumin Morava e Binçës- Kurbuliq me 0.006 mg/l N-NH<sub>4</sub><sup>+</sup> përkatësisht 0.654 mg/l dhe vitet 2016 dhe 2017 në lumin Lepenc- Prevallë me vlerë të njejtë 0.063 mg/l.

Përderisa, maksimumi i VMV të parametrin azoti i amoniumit, për vitin 2014 paraqitet në lumin Nerodinja- Gërlicë ka vlerë 2.023; ndërsa në vitet 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019 maksimumi i VMV paraqitet në lumin Nerodinja - Kaçanik me interval vlerë nga 2.335 mg/l deri 4.895 mg/l.

**Fosfori i ortofosfateve (P-PO<sub>4</sub><sup>3-</sup>)** - minimumi i VMV në vitet 2014 dhe 2018 paraqitet në lumin Kriva Reka- Marec me vlerë 0.038 mg/l përkatësisht 0.035 mg/l; viti 2015 minimumi i VMV paraqitet në lumin Lepenc- Prevallë me vlerë 0.060 mg/l; viti 2017 minimumi i VMV paraqitet në lumin Morava e Binçës- Kurbuliq me vlerë 0.049 mg/l; dhe në vitet 2016 dhe 2019 minimumi i VMV paraqitet në lumin Nerodinja- Jezerc me vlerë 0.101 mg/l përkatësisht 0.005 mg/l.

Vlerat maksimale të VMV, Për vitet 2014, 2016 dhe 2019 janë paraqitur në lumin Morava e Binçës- Ranilugë me interval vlerash nga 0.292 mg/l deri 0.477 mg/l. Ndërsa, në vitet

2015, 2017 dhe 2018 Vlerat maksimale të VMV janë në lumin Nerodimja-Kaçanik me interval vlerë nga 0.463 mg/l deri 0.571 mg/l (shih Figuren.48).




Figura 48: Fosfori i ortofosfateve (mg/l) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës

Nga rezultatet konkludojmë se parametri fosfat gjatë këtyre gjashtë viteve të monitorimit vlerë maksimale ka në lumenjtë Morava e Binçës dhe Nerodimja, më saktësisht jonet fosfate me vlera më të ngritura paraqiten kryesisht në ato stacione monitorimi pas shkarkimeve urbane dhe industriale.

**Fosfori total (poli dhe orto)** - edhe ky parametër në vendburime ka vlera të ulëta, por përgjatë rrjedhjes së lumenjëve, vlera totale e parametrit të fosforit, shënon rritje.

Maksimumi i VMV në vitin 2016 është matur në lumin Nerodimja- Gërlicë me vlera 1.835 mg/l; në vitin 2017 në lumin Morava e Binçës- Ranilugë shënon vlerë 1.740 mg/l; dhe në vitet 2014, 2015 dhe 2019 është matur në lumin Nerodimja- Kaçanik me vlera nga 0.360 mg/l deri 1.163 mg/l ( shih Figuren.49).




Figura 49: Fosfori total (poli dhe orto)( mg/l ) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës

### 5.3. Monitorimi i ujërave nëntokësore/Planit monitories

Komponenti “Ngritja e rrjetit të monitorimit të ujërave nëntokësore në Kosovë, është një nga tetë komponentët teknik të Programi për mjedisin, klimës dhe menaxhimit të burimeve ujore, propozuar nga MMPH dhe financuar nga Agjencia Suedez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

Objektiv i kësaj komponente është që IHMK/AMMK të krijoj rrjetin e monitorimit të ujërave nëntokësore, shtrirja e të cilit do të ketë një mbulueshmëri të mirë të të gjitha pellgjeve lumore të Kosovës. Përmes kësaj komponente do të bëhet rehabilitimi i puseve ekzistuese dhe selektimi i puseve të reja (të ndërtuara nga komponenta 6) për monitorim, si dhe paisja me instrumentë matëse. Selektimi i puseve për monitorim është bërë bazuar në analizën e lokacionit në aspektin hidrogjeologjike, të presionit antropogjen dhe në kriterin e qasjes së lehtë tek pusi monitorues, konkretisht është marrë në konsideratë pusi me:

- Kapacitet (debit) më të mirë;
- Shtrirje në trupin ujorë nëntokësorë (akuifer);
- Qasja më e lehtë (prona publike është prioritet); dhe
- Presionët antropogjenë

Bazuar në kriteret e lartpërmendura dhe duke pas në konsideratë edhe kapacitetet ekzistuese janë përcaktuar që në këtë fazë rrjeti i monitorimit të ujërave nëntokësore të ketë 32 puse monitoruese (shih fig.50), të cilat do të pajisen me sensor për matjen e nivelit të ujërave në puse dhe sensor për matjen e cilësisë së ujërave. Puset do të jenë në këtë konfigurim gjeografik;

12 puse në pellgun e Drinit të Bardhë,

- 8 puse në pellgun e Ibrit,
- 6 puse në pellgun Morava e Binqës dhe
- 6 puse në pellgun e Lepencit.<sup>20</sup>

20

Rrjeti i monitorimit të ujërave nëntokësore(Draft)-AMMK/IHMK, Prishtinë,2019




Figura.50. Harta e rrjetit hidrografik dhe puset monitoruese.

## 5.4. Monitorimi i ujërave për pije

Cilësia e ujit të pijes i referohet karakteristikave mikrobiologjike dhe fiziko-kimike. Cilësia e ujit të pijshëm është një tregues i rëndësishëm për mirëqenien dhe shëndetin e popullsisë. Kosova ka një legjislacion të mirë për mbrojtjen e ujërave për pije. Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2012, Udhëzimin Administrativ Nr.15/2017, janë ndër udhëzimet me me rendësi për mbrojtjen e ujërave të pijshëm dhe të cilat janë në përputhje me standardet e BE- së, për ujin e pijshëm.

KRU kanë përgjegjësinë për të furnizuar me ujë cilësor konsumatorët e tyre, ato gjithashtu kanë obligim për të bërë monitorimin/testimin intern të kualitetit të ujit. Nga ana tjetër IKSHPK, është Institucion me përgjegjësinë ligjore për të bërë kontrollin dhe monitorimin e ujërave të pijshëm në tërë territorin e vendit. IKSHPK siguron se uji i distribuuar nga KRU është në përputhje me vlerat sipas standardit vendore për parametrat mikrobiologjik dhe fiziko-kimik. Në këtë raport vlerësimi i cilësisë është bërë në bazë të të dhënave të raportuara nga QU në ARRU.

Bazuar në rezultatet e monitorimit të kryer nga Qendra e Ujit e Instituti Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKSHPK) konform përgjegjësi që ka, cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë që u ofrohet konsumatorëve në zonat e shërbimit të shtatë KRU-ve, rezulton se gjatë viteve 2018/2019, ka qenë në përputhje me standardet e ujit të pijshëm. Gjatë vitit 2018, janë marrë 8,598 mostra të ujit në rubinetet e konsumatorëve me qëllim të testimeve të cilësisë së ujit në aspektin fiziko-kimik dhe mikrobiologjik, në të cilën 99.4% të mostrave kanë qenë në përputhshmëri me standardet e kërkuara. Ndërsa në vitin 2019 janë marrë 9,229 mostra të ujit nga rubinetet e me qëllim të testimeve të cilësisë së ujit në aspektin fiziko-kimik dhe mikrobiologjik.(shih Figuren.51) Nga totali i mostrave të marra për testim 98.8% të tyre kanë qenë në përputhje me standardet vendore të cilësisë së ujit. Duke u referuara nga këto statistika, vlerësohet se cilësia e ujit e furnizuar nga KRU është në nivel shumë të mirë ( shih Tabelen.13).




Figura 51. Përputhshmëria e testeve për uji të pijes sipas standardeve vendore për parametrat bakteriologjike dhe kimike (KRU-te, 2018/2019)

Siç mund të shihet nga tabelen 13 gjatë vitit 2018 përputhshmëria më e lartë sa i përket vlerave të parametrave mikrobiologjikë ka qenë në KRU Prishtina 100%, ndërkaq përputhshmëria më e ulët në KRU Bifurkacioni 97,1%. Në vitin 2019, gjendja e përputhshmërisë me lartë për parametrat mikrobiologjik ishte në KRU Prishtina, Hidroregjioni Jugor, Gjakova me 100%, ndërsa me e ultë ishte në KRU Bifurkacioni me 95.5%, që kishte ramje prej 1.6% në krahasim me vitin paraprak.

Tabela 13: Norma (%) e testeve bakteriologjike dhe fiziko-kimike në përputhje me standardet e cilësisë së ujit sipas KRU-2018/2019

Kompanitë	Viti	KRU Prishtina	KRU Hidroregjioni Jugor	KRU-Hidrodrini	KRU Mitrovica	KRU Gjakova	KRU Bifurkacioni	KRU Hidromorava	Mesatare e sektorit
Mikrobiologjike	2018	100%	99.7%	98.7%	99.6%	99.7%	97.1%	98.3%	99.3%
	2019	100.0%	100.0%	99.3%	99.5%	100.0%	95.5%	96.9%	<b>99.2%</b>
Fiziko-Kimike	2018	98.9%	99.4%	100%	100%	100%	98.2%	99.4%	99.5%
	2019	99.8%	100.0%	100.0%	97.6%	100.0%	91.7%	92.1%	<b>97.9%</b>
Mesatarja për KRU	2018	99.7%	99.6%	99.1%	99.7%	99.8%	97.4%	98.8%	99.4%
	2019	<b>99.9%</b>	<b>100.0%</b>	<b>99.5%</b>	<b>99.1%</b>	<b>100.0%</b>	<b>94.5%</b>	<b>94.9%</b>	<b>98.8%</b>

Nga KRU 'Hidromorava dhe Bifurkacioni është një furnizim me cilësi me të ultë me uji të pijes si në aspektin bakteriologjik ashtu edhe në aspektin fiziko-kimik, për shkakun e mungesës së furnizimit të rregullt me ujë të pijes.

**Mbulueshmëria me shërbimin e furnizimit me ujësjellës** gjatë këtyre viteve sipas ARRU arrin shkallën prej 75%, ndërsa mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura arrinë shkallën prej 65 %. KRU Prishtina, Gjakova dhe Hidrodrini, kanë arritur mbulueshmëri të lartë të popullatës me shërbime në kuadër të zonave të tyre respektive të shërbimeve.

Në kuadër të angazhimit të mëtejme për të përmirësuar aspektin e sigurisë së cilësisë së ujit, ofruar konsumatorëve dhe popullatës, IKSHPK është duke u angazhuar për avancimin, gjegjësisht azhurnimin e UA 16/2012, në frymën e kërkesave të fundit të Direktivës Evropiane dhe Rekomandimeve të OBSH.



## 6. UJËRAT E SHKARKUARA NDOTËSE DHE TRAJTIMI

### 6.1. Ujërat e shkarkuara urbane

Ujërat urbane shkarkohen akoma në ujërat e lumenjëve sit ë patrajuara. Ujërat urbane të patrajuara vlerësohen së janë mbi 35-40 milion m<sup>3</sup>. Trajtimi i ujërave urbane është i nivelit të ultë. Kosova përpos impiantit për trajtim të ujrave urbane në Skenderaj, në Gjakovë, një mini impianti në Batllavë dhe ai për trajtim biologjik në Halilaq, akoma nuk ka investime në këtë sektor.

Sipas statistikave të ujërave të Kosovës, prej vitit 2015-2018, kemi pasur një ndryshueshmeri të ujërave të zeza të shkarkuar (shih Tabelen.14).

Tabela 14. Ujërat urbane të shkarkuara për vitet 2015-2018

Vitet	Ekonomitë familjare Ujërat e zeza m <sup>3</sup>
2015	34,230,062
2016	35,400,797
2017	37,713,245
2018	35,025,024

Investimet për trajtimin e ujravë urbanë në Kosovës janë të vlersuar sipas burimeve të ndryshme të cilat janë të paraqitur në Tabelën. 15 sipas strategjisë shtetore per ujërat 2017-2036<sup>21</sup>

Tabela 15. Parashikimet për investimet për trajtimin e ujërave urbane

Vlerësimet	Kostoja
AMVA të Bankës Botërore:	€424 milionë (vlerësim gjenerik për zgjerim pa rinovim)
Modeli i përputhshmërisë	€800 milionë (duke përfshirë: rinovimet, ujërat atmosferike, të gjitha aglomeracionet)
Modeli i përputhshmërisë	€493 milionë (implementim minimal)
Planet për investime:	€75 milionë (vlerësim i përshtatur – përjashton ujërat atmosferike)
Studimet e fizibilitetit	€57 milionë (përjashton “aglomeracionet më të vogla”)

21 Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017 - 2036

## 6.2. Ujërat e shkarkuara industriale

Si instrument kryesore për parandalimin e ndotjës së ujërave nga shkarkimet industrial është respektimi i Ligji Nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes “. Zbatimi i këtij ligji do të mundëson parandalimin e shkarkimeve të ujërave industrial në lumënjë si të patrajtuar. Shfrytëzimi i ujëravë nga ana industrisë është shumë i madhë dhe në të njëjtin kohë edhe shkarkimi i ketyre ujërave (shih Tabelen.16).

Tabela 16.Ujërat e shkarkuara industria dhe operatorët ekonomik në vitet 2015-2018

Vitet	Operatorët industrial dhe ekonomik Ujërat e shkarkuara m <sup>3</sup>
2015	4,392,660
2016	4,874,424
2017	5,050,495
2018	5,013,557

## 6.3.Trajtimi ujërave urbane, industriale dhe agrokultura

Trajtimi i ujërave urbane në vend është shumë i ulët. Aktualisht, si impiant i trajtimit të ujërave të ndotura me përmasa më të mëdha është në Skenderaj i menaxhuar nga KRU ‘Mitrovica’(shih Figuren.52)dhe disa impiante të vogla në nivel lokal. Pjesa tjetër e ujrave urbane nuk e përmbushin standardet mjedisore te shkarkimit të tyre në lumenjë.

Uji i trajtuar në impiantin në Skenderaj varirion prej vitit në vit dhe nga forma e funksionimit të saj (shih Tabelen.17).

Tabela 17. Trajtimi i ujërave urbane në Impaintin në Skenderaj, vitet 2015-2019<sup>22</sup>

Vitet	Impianti në Skenderaj Ujërat e trajtuara m <sup>3</sup>
2015	595697
2016	487534
2017	521998
2018	761012
2019	967629



Figura.52. Impianti për trajtimin e ujërave në Skenderaj

## 7. RREGFULLIMI DHE KONTROLLIMI I UJËRAVE

### 7.1. Paralajmërimet e hershëm për vërshimet

Përmbytjet (vërshimet) si dukuri natyrore zakonisht ndodhin si pasojë e të reshurave me intensitet të lartë dhe shkrirjes së shpejtë të borës. Karakteristikat kryesore të lumenjëve në Kosovë janë: ndryshimet e dallueshme në mes niveleve minimale dhe maksimale të regjimit të ujërave. Karakteristika të ndryshme morfologjike në terren si fushat e gjera të rrethuara me male, rezultojnë në zhvillimin e shpejtë të vërshimeve që i përshtatën vërshimeve të zgjeruar dhe dinamike. Shtretërit relativisht të cekët të lumenjëve, të parregulluara, si dhe të pa mirëmbajtje, hedhja e mbeturinave në shtretërit e lumenjëve dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i materialeve inerte nga shtretërit e lumenjëve ndikojnë në përmbytje në përmasa më të mëdha në Kosovë. Në bazë të vlerësimeve që i përmban Master Plani për Ujëra i 1983-së për përmbytjet me rastisje një herë në 100-vite mund të jenë me ndikime të konsiderueshme:

#### Paralajmërimi i vërshimeve gjatë vitit 2015

Reshjet intensive të shiut gjatë këtyre ditëve, janë si pasojë e ciklonit të ardhur nga pjesa veri-perëndimore e Kontinentin Evropian, në të cilin është përfshi edhe vendi jonë nga një mot i përcjellur me reshje shiu të intensiteti të lartë, sidomos nga data 04, duke arritur maksimumin gjatë datës 5 dhe 6 shkurt 2015, me intensitet me të theksuar të shpërndarjes kohore dhe hapësinor sidomos në pjesën perëndimore dhe qendrore të Gadishullit Ballkanik. Këto të reshura kanë shkaktuar ngritjen e shpejtë të nivelit të ujit të lumenjëve të Kosovës të cilët janë të vrullshëm për shkak të karakterit malor të tyre, ku si pasojë shumica e tyre kanë ndalur nga shtrati duke shkaktuar përmbytje në disa zona të Kosovës. Situata hidrologjike është pothuajse e njëjtë në tërë territorin e Kosovës, por më tepër e rënduar është në pellgun e Lumit Sitnica, duke përfshi shumicën e ujë-rrjedhave të sajë nga të dyja anët, duke filluar nga pjesa qendrore e fushëgropës së Kosovës (Lipjani dhe rrethina e sajë, Fushë Kosova, Obiliqi, Vushtrria) etj. Edhe dega e djathtë e Sitnicës Lumi Llap, në rrjedhën e tij të mesme dhe sidomos në atë të poshtme (Lluzhan, Lupç i Ulët) etj, duke përmbytur tokat në të dy anët e sajë. Problematike paraqiten rrjedhat malore me karakter rrëkesh (prrockat, prrojet) etj të cilat për shkak të konfiguracionit të relievit, kanë karakter vërshues duke shkaktuar dëme nëpër disa fshatra dhe lagje qytetesh, në disa vise të Kosovës. Situata pothuajse e njëjtë paraqitet edhe në pjesën Lindore të Kosovës, në pellgun e Moravës së Binçës, sidomos në rrjedhën e mesme dhe të poshtme të ijë, duke ndalur nga shtrati nga vendbanimet: Budrik e Ulët, Lladovë, Dobërçan, Rranillug, Korminjan, pastaj Kriva Reka në Domaroc dhe rrjedhat e saja nga ana e majtë (lumi i Hogoshtit, Hodonocit, Karaçevës etj) ku si pasojë disa shtëpi nëpër disa fshatra janë të përmbytura nga uji dhe janë shkaktuar dëme në infrastrukturën rrugore.

## Paralajmërimi i vërshimeve për gjatë vitit 2016

Siç shte treguar përmes analizës se SPI/ viti 2016 ka qenë viti pak me i lagështë. Gjatë dimrit, pranverës dhe vjeshtës janë bërë disa paralajmërime të vërshimeve për Rrafshin e Dukagjinit, Rrafshin e Kosovës (Pellgun e Lumit Iber) dhe për të gjithë Kosovën. Tabela 18 liston paralajmërimet zyrtare të vërshimeve në Kosovë dhe pjesët e tjera për të cilat ishin lëshuar. Figura 53 pershkruan si shëmbull një zonë të vërshuar afër Nadakocit pergjat lumit sitnica me 10 nëntor 2016. Vërshimet ndodhen për shkak të një sistemi frontal të shirave të mëdha mbi ballkanin nga veri-perëndimi në jug-lindje për disa ditë.

Tabela 18: Paralajmërimet zyrtare të përmbytjeve në Kosovë në vitin 2016.

Nr.	Nga	Deri	Zona e prekur
1	06/01/2016	09/01/2016	E gjithë (tërë) Kosova
2	07/03/2016	08/03/2016	Rrafshi i Kosoves
3	13/03/2016	15/04/2016	E Tërë Kosova
4	02/04/2016	05/04/2016	E Tërë Kosova
5	21/05/2016	22/05/2016	E Tërë Kosova
6	06/09/2016	08/09/2016	Rrafshi i Dukagjinit
7	07/11/2016	09/11/2016	E tërë Kosova



Figura 53: Zone e përmbytur nga lumi Sitnica afër Nadakoc me 10 nëntor 2016.

## Parashikimi i vërshimeve 2017

Theksohet se gjatë vitit 2017, nuk ka pasë ndonjë vlerësim për parashikimet e vërshimeve në Kosovë.

Sipas Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, me datën 03/02/2018, ka pasur reshje të

dëndura të shiut, fillimisht në pjesën perëndimore të Kosovës (zona malore e Bjeshkëve të Nemuna) të cilat kanë shkaktuar formimin e shpejtë të rrëqeve në atë zonë dhe shkaktimin e vërshimeve të shpejta. Intensiteti i reshjeve në disa zona ka qënë 25-40 mm/3h, ku si pasojë ka pasur ngritje të niveleve nëpër rrjedhat lumore dhe dalje nga shtretërit e tyre në disa segmente lumore si dhe dëme materiale. Piku i niveleve më të lartë nëpër lumenjë arrin nga ora 18 te cilët ka vazhduar edhe gjatë ditës se nesërme. Nivelet e ujit në lumenjtë kryesore të vendit gjatë kësaj kohe:

- Drini Bardhë në Gjonaj – niveli arrin në 321 cm,
- Bistrica Pejës në Grykë – niveli arrin në 135 cm,
- Lepenci në Hanin e Elezit- niveli arrin në 162 cm,
- Drini i Bardhë në Kepuz - niveli arrin në 213 cm,
- Sitnica në Nedakoc – niveli arrin në 169 cm,
- Ibri në Leposaviq- niveli arrin në 180 cm,
- Morava Binçes në Konçul – niveli arrin në 294 cm.

Po ashtu në zonat e ndjeshme afër lumenjëve ka pasur edhe rrëshqitje të dheut.




Figura 54. Disperzioni i përfshirjes së thatësisë

### Parashikimi i vërshimeve 2019

Spektori i Hidrologjisë i Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës ka parashikur se do të ndodhin vërshime për shkak të reshurave të mëdha që do përfshijnë vendin në ditët në vijim.

Sipas njoftimit të IHMK vërshimet paraqiten me datën 14.05.2019, dhe përfshijnë pjesën perëndimore, jugore dhe veriore të Kosovës (shih Figurën.55).

Parashikimet që reshjet të fillojnë 72 orë pas shpalljes se njoftimit, me një sasi prej >30

- 50 mm, dhe me probalitet të lartë të reshjeve ekstreme, përmbytjeve dhe rëshqitje të dhuet në zonat e ndjeshme.

Zonat më të goditura do të jenë pjesa perëndimore dhe jugore e vendit.



Fig.55. Foto nga vërshimet

**Me datën 06/11/2019**, fillimisht në pjesën perëndimore të Kosovës (zona e Alpeve Shqiptare kanë vazhduar reshje të shiut me intensitet të ulët deri në mesatare, të cilat gjatë ditës ka përfshirë edhe pjesën veriore dhe veriperëndimore të vendit. Ndërsa nga datë 07/11/2019, reshjet e shiut përfshinë pjesën më të madhe të Kosovës, me intensitet më të lartë në Dukagjin.

## 7.2. Thatësitrat

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës në bazë të monitorimit të kushteve të thatësisë / lagështisë në Republikën e Kosovës për periudhën gjashtëmujorë hidrologjike tetor 2019 - mars 2020 ka bërë një analizë të gjendjes bazuar në Indeksin Standard të Reshjeve (shih Figuren.56).

Kosova është vend i predispozuar për thatësira. IHMK / Sektori i Hidrologjisë në vazhdimësi përcakton SPI-në për një seri vendndodhjesh në Kosovë nga te cilat monitorohen reshjet. SPI përcaktohet me qëllim që te jep informacion për publikun, kompanitë e ujit dhe politik-bërësit mbi thatësitrat, për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Kosovës dhe menaxhim më të mirë të resurseve ujore.

Sikurse është prezantuar edhe përmes hartes, analiza e SPI tregon se për gjashtë mujorin hidrologjik, Tetor 2019 - Mars 2020, kushtet e lagështisë/thatësisë në Kosovë janë afër gjendjes normale në pjesën më të madhe të Kosovës. (shih Figuren.57).

Gjatë kësaj periudhe lokacionet në Kosovën jug-perëndimore kanë treguar se vendi është

afër gjendjes së thatësisë së ulët, ndërsa pjesa e Kosovës Lindore është afër gjendjes së normales, përjashtim bën një pjesë e Kamenicës në të cilën bazuar në kalkulimin e SPI është paraqitur gjendje e thatësisë.




Figura 56. Te reshurat sipas Indeksi i Standardeve të Reshjeve





Figura 57. Thatësira në Liqenin e Badovcit

### 7.3. Zonat eruzive

Erozioni është njëra ndër format më të ashpra të degradimit të tokës, pyjeve, peisazheve, shpateve malore, infrastrukturës së banimit dhe asaj rrugore.

Nuk ka informacione të plota për të vlerësuar dëmet e shkaktuara nga erozioni. Për parandalimin e erozionit duhet të zabtohen dispozitat e përcaktuara në Ligjin për Ujëra si dhe të implementohen veprimet e përcaktuara në Planin Hapësinor 2010-2020. Në kuadër të veprimeve të nevojshme duhet të përfshihen edhe masat hidroteknike dhe masat për menaxhimin e tokës.

Pra, për parandalimin e erozionit kërkohet një serë masash teknike, programore dhe ligjore sikurse janë:

- Kufizimi i zonave të rrezikuara nga erozioni dhe zhvillimi i kontrolleve adekuate për secilën zonë.
- Përcaktimi ligjor i zonave të rrezikuara nga erozioni.
- Informimi i rregullt dhe dhënia e udhëzimeve për të gjitha entitetet e prekura.
- Implementimi i një programi që ka për synim zbatimin e ligjeve kundër shkeljeve të dispozitave që vlejnë për zonat e mbrojtura.

### 7.4. Digat

Ligji Nr. 04/L-147 për Ujrat e Kosovës i mbulon disa aspekte në lidhje me digat e akumulacioneve të ujit si; menaxhimi, vrojtimi dhe alarmi në rast të rrezikut nga digat.

Digat kanë struktura të thjeshtë dhe masive. Sidoqoftë ato ruajnë sasi të mëdha të ujit, e cila sasi nëse nuk kontrollohet mund të shkaktojë humbjen e jetës dhe pasurisë. Siguria e digave varet prej 4 shtyllave, ato janë:

- Kornizë e qartë legjislative e cila përcakton përgjegjësitë e pronarit të digës dhe sistemit kontrollues të autoritetit qeveritar.
- Koncepti i dizajnit modern duke marrë parasysh rreziqet natyrale dhe teknologjike, përzgjedhjen e materialit të duhur dhe ndërtimet e monitoruara me kujdes.
- Vrojtimi i kujdesshëm i sjelljes së digës dhe krahasimi i vazhdueshëm i vlerave të matura me sjelljet e parashikuara.
- Konceptet e duhura emergjente dhe organizimi i alarmimit.<sup>23</sup>

Tabela 19. Digat në Kosovë

Nr.	Digat	Të dhënat
1	Diga e Batllavës	Lloji i digës-Digë rrethore me bërthamë argjilore Qëllimi - Furnizimi me ujë Fillimi i punës-1960 Lartësia-46.45 m Gjatësia e kurorës-288m, Niveli i kurorës - 638.45 masl Lartësia mbi ujë-3.45m Niveli i rezervuarit 40 000 000 m <sup>3</sup> Zona e ujë mbledhësit -226 km <sup>2</sup>
2	Diga e Badovcit	Lloji i digës-Digë rrethore Qëllimi - Furnizimi me ujë Nisja e punës - 1960 Lartësia- 45.0 m Gjatësia e kurorës-289 m Niveli i rezervuarit - 32 Mio. Zona e rezervuarit - 1'563'000 m <sup>3</sup>
3	Diga e Radoniqit	Lloji i digës- Digë rrethore, bërthamë qendore Qëllimi-Furnizimi me ujë dhe ujitja Fil- limi i punës- viti 1982 Lartësia - 61 m Gjatësia e kurorës-770 m Niveli i rezervuarit-113 M m <sup>3</sup> Zona e rezervuarit-573 ha Zona e ujëmbledhësit -180 km <sup>2</sup>

23

Projekt i TFU - Rishikimi i Sigurisë së Digave në KosovëWTF Project - Dam Safety Review Kosovo, 2012

4	Diga e Ujmanit/Gazivoda	Lloji i digës -Digë rrethore, bërthame qendrore Qëllimi -Ujë Fillimi i punës -1979 Lartësia -101m Gjatësia e kurorës- 519m Niveli i rezervuarit -370 000 000 m3; në realitet 350 000 000 m3 Zona e rezervuarit -11.9 km <sup>2</sup> , prej të cilave 9.2 km <sup>2</sup> i takojnë Kosovës dhe 2.7 km <sup>2</sup> I takojnë Serbisë Zona e ujë mbledhësit -1100km <sup>2</sup>
5	Diga e Prilepnicës	Lloji i digës -Digë rrethore me bërthamë argjilore Qëllimi -Ujë Fillimi i punës -1982 Lartësia -40 m Gjatësia e kurorës -165 m Niveli i rezervuarit -4 200 000, në realitet 3 300 000 m3 Zona e rezervuarit -18.24 Zona e ujë mbledhësit 55 km <sup>2</sup>

### 7.5. Zonat e degraduara (viti 2012-2018)

Lumenjtë tanë në dekadën e fundit duke mos anashkaluar periudhën e mëparshme, i'u kanë nënshtruar një trysnie apo presioni gjithnjë në rritje nga veprimtaria e njeriut dhe zhvillimi ekonomik, e cila në shumicën e rasteve është shprehur jo konform zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor dhe me pasoja afatgjate. Shumë lumenjë të vendit po pësojnë nga degradimi dhe shfrytëzimi i tepruar për lëndët inerte. Mbishfrytëzimi pa kriter i inerteve ka determinuar në shfrytëzimin e rezervave natyrore të lumenjve mbi kapacitetet regjenerues të tyre. Aftësia natyrore e lumenjve për t'i mbuluar gropat e hapura me sipërfaqe të tëra, shumë pjesë mund të llogariten të pakthyeshme. Gjendja mjedisore e lumenjve vazhdon të përkeqësohet në masë të madhe nga eksploatuesit e zhavorit.

Lumenjtë më të degraduar dhe që ende vazhdojnë të degradohen janë;

- Lumi Drini i Bardhë,
- Lumëbardhi i Pejës;

- Lumi Ereniku - Gjakovë ;
- Lumi Desivojcë dhe Krivareke – Kamenicë;
- Lumi Ibri-Mitrovicë.

Sipërfaqja e degraduar nga eksploatimi i zhavorit deri ne vitin 2018 është verësuar se është 1421.06 ha. Që nga viti 2009 e deri ne vitin 2018, sipërfaqja degraduese e lumenjëve është rrit për 414.78 ha.

Mënyra dhe metoda me e vlerësimit dhe analizimit te gjendjes mjedisore të lumenjve ishte që të veprohet sipas studimeve dhe modeleve krahasuese, duke u bazuar në gjendjen e terrenit dhe imazhet satelitore të ortofotove 2009/2012/2018 (Shih Tab.20 dhe Figuren. 58).

Tabela 20. Sipërfaqet e shtretërve të lumenjëve të degraduara për vitet 2009-2018

Nr.	Viti	Siperf. ha
1	2009	1006.28
2	2012	1221.07
3	2018	1421.06



Figura. 58. Degradimi i Lumit Drini i Bardhë për pëirudhën 2012-2018.

## 8. SHËRBIMET, INFRASTRUKTURA DHE INVESTIMET

### 8.1. Tarifa për shfrytëzimin e ujerave /ujësajlls dhe kanalizim

Bazuar në UA 02/2016 për Strukturën e Pagesave të ujit, respektivisht Kompensimet për shfrytëzuesit e ujit tarifat janë si vijon:

Tabela 21. Ujërat e pa trajtuara të cilat merren drejtëpërdrejtë

Nr.	Format e marrjës së ujërave	m <sup>3</sup> , ha, %
1	Nga ujërrjedhat	0.003 €m <sup>3</sup>
2	Nga ujërat nëntokësorë	0.001 €m <sup>3</sup>
3	Nga akumulimet artificiale sipërfaqësore	0.002 €m <sup>3</sup>
4	Nga ujërat termale që përdoren për banja kuruese dhe ngrohje	0.01 €m <sup>3</sup>
5	Prodhuesit që ambalazhojnë ujin natyral dhe mineral paguajnë	0.001 për liter të shitur
6	Shfrytëzuesit e ujit për ujitje të cilët përdorin ujin nga Ujë rrjedhat	5 €hektar
7	Shfrytëzuesit e ujit për ujitje të cilët përdorin ujin nga akumulimet artificiale sipërfaqësore	10 €hektar
8	Shfrytëzuesit e ujit për ujitje të cilët përdorin ujin nga Ujërat nëntokësorë	2.5 €hektar
9	Shfrytëzuesit e ujit për hurdhat e peshqve	0.03 €m <sup>3</sup>
10	Shfrytëzuesit e ujit për bazen sportive të cilat përdoren për peshkim	2.5 €hektar
11	Shfrytëzuesit për prodhimin e energjisë elektrike për çdo kilovat-orë të prodhuar në hidrocentral	25% të çmimit të shitur
12	Çdo kilovat-orë të prodhuar në termocentralet me sistem të mbyllur të ftohjes	1.7% të çmimit të shitur
13	Shfrytëzuesit e ujit për pishina paguaj	2.5% të çmimit për çdo bilet të shitur në hyrje
14	Shfrytëzuesit që përdorin ujin për ftohje në proceset teknologjike	0.002 €për 1m <sup>3</sup>

**Kompensimi për shkarkimin e ujërave të ndotura**

Nr.	Format e shkarkimit të ujërave	m <sup>3</sup>
1	Ujërat e përdorura në proceset tekniko-teknologjik për përpunimin dhe qarkullimin e naftës dhe derivative të naftës, metalurgjisë së zezë, metalurgjisë së ngjyrosur, industrisë së tekstilit, industrisë së letrës, lëkurës, farmave, thertoreve, industrisë së mishit, serviseve të automjeteve dhe makinave	0.03 €
2	Ujërat nga industritë tjera të cilat nuk janë caktuar më lart dhe llojet tjera të ujërave të ndotura	0.02 €m <sup>3</sup>
3	Ujërat urbane të cilat mblidhen në sistemin e kanalizimit	0.001 € m <sup>3</sup>
4	Ujërat për ftohje në termocentralet me sistem të hapur të ftohjes	- 1.5% €m <sup>3</sup> .

**8.2. Aktet ujore, Pëqimet ujore, Lejet ujore**

Tabela 22. Aktivitetet për leje dhënie në fushën e ujërave

Aktivitetet për leje- dhënie në fushën e ujërave	2019
Kushte Ujore	3
Pëlqime Ujore	11
Leje Ujore	3
Vazhdime të Lejeve Ujore	3
Vendime për refuzim të Lejes Ujore	3
Ndryshim të Vendimeve	0
Konkluzione	0

**8.3. Infrastruktura, Projektet dhe Investimet në Sektorin e Ujërave**

Investimet në sektorin e ujërave nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës janë realizuar me financimin e projekteve kapitale për Autoritetin e Rajonit të Pellgjeve Lumore / MIA (MMPH).

Gjatë vitit 2019 këto investime të financuara nga buxheti i shtetit kanë qenë të fokusuara përmes projekteve në:

- Rregullimin dhe rehabilitimin e shtretërve të lumenjve;
- Ndërtimin e kanaleve të ujitjes;

- Rregullimin e hapësirës tek burimet ujore;
- Zgjerimin e rrjetit sekondar dhe kyçjet individuale në ujësjellës;
- Studimin, riparimin e pajisjeve monitoruese të digave ekzistuese në Kosovë;
- Renovimin dhe ndërtimin e infrastrukturës mbrojtëse përgjatë lumenjve;
- Studimi i fizibilitetit të zonave erozive;
- Hartimin e kadastrit të ujërave;
- Impiantet për ujëra, ujësjellësit;
- Rrjetin e kanalizimeve;
- Pastrimin e lumenjëve.

#### Projektet e vitit 2018:

- Ndërtimin e ujësjellësit;
- Rregullimin i sistemi të ujësjellësit;
- Ndërtimi i shtretërve të lumenjve;
- Ndërtimin e shtëpisë së peshkatarëve në liqenin akumulues;
- Kyçjet individuale në ujësjellës;
- Ndërtimi i gypsellësit.

#### Projektet kapitale 2017:

- Ndërtimi i kanalizimeve;
- Ndërtimi ujësjellësve;
- Rregullimi dhe rehabilitimi i shtretërve të lumenjve;
- Akumulimi i ujit;
- Sistemi i ujerave te zeza dhe projekti i përmirësimit infrastrukturual;
- Rehabilitimi i ujësjellësit dhe rritja e kapacitetit te ujit;
- Rregulli i kanalit te ujitjes;
- Fabrika e ujërave te zeza;
- Studimi, riparimi dhe pajisjet monitoruese te digave ekzistuese te Kosovës;
- Vlerësimi preliminar për mbrojtje nga përmbytjet me hartat e rrezikut dhe rrezikshmërisë për pellgje lumore;
- Pastrimi i profileve kriterike-emergjente te lumenjve për mirëmbajtje te kapacitetit bartës te ujërrjedhave;
- Hartimi i kadastrit te ujërave;
- Renovimi dhe ndërtimi i infrastrukturës mbrojtëse përgjatë lumenjve;
- Studimi i fizibilitetit për zonat erozive, pritrat malore;
- Impianti për ujëra te zeza.

#### Projektet kapitale 2016:

- Ndërtimin e murit mbrojtës nga vërshimet në lumë;
- Rehabilitimi dhe rregullimi i shtretërve të lumenjëve;
- Ndërtimi i kanalizimeve;
- Akumulim ujërave;

- Sisteme të ujërave të zeza;
- Rehabilitimi i ujësjellësve dhe rritja e kapacitetit të ujit;
- Rregullim i kanalit të ujitjes;
- Fabrika e ujërave të zeza;
- Hapja dhe pastrimi i lumenjve;
- Renovim i digave të lumit;
- Ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza; dhe
- Rekonstruktim dhe sanim të rrjetit të ujësjellësit të kanalizimit.

Projektet kapitale 2015:

- Ndërtimin e murit mbrojtës nga vërshimet në lumë;
- Ndërtimi, rehabilitimi dhe rregullimi i shtretërve të lumenjëve;
- Ndërtimi i kanalizimeve;
- Ndërtimi rrjetit të ujësjellësve;
- Akumulim ujërave;
- Aisteme të ujërave të zeza;
- Punimi i kanalit derijvues për mbrojtjen e moseutrofikimit të liqeni
- Rehabilitimi i ujësjellësve dhe rritja e kapacitetit të ujit;
- Rregullim i kanalit të ujitjes.

Tabela 23. Investimet nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës

Bazuar në Projektligjin për buxhetin e Kosovës për vitin 2020, nga buxheti i Kosovës	Janë planifikuar për financim 52 projekte kapitale për nivelin qendror	Vazhdim nga viti 2019 janë investuar <b>11,153,631.00€</b>	Investime të reja në vitin 2020 kanë qenë <b>2,510,431.00€</b>	Vlerësuar për vitin 2021 janë <b>3,100,000.00€</b>	Në vitin 2020 janë realizuar në total <b>13,664,062.00€</b>	
Bazuar në Ligjin për buxhetin e Kosovës për vitin 2019, nga buxheti i Kosovës	Janë financuar 75 projekte kapitale për nivelin qendror	Vazhdim nga viti 2018 janë investuar <b>9,103,548.00€</b>	Investime të reja në vitin 2019 kanë qenë <b>8,655,426.00€</b>	Vlerësuar për vitin 2020 janë <b>19,061,868.00€</b>	Në vitin 2019 janë realizuar në total <b>17,758,974.00€</b>	Ligji Nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 / Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 4 / 14 Shkurt 2019, Prishtinë / link <a href="https://gzk.rks-gov.net/Act-Detail.aspx?ActID=18554">https://gzk.rks-gov.net/Act-Detail.aspx?ActID=18554</a>



GJENDJA E UJËRAVE NË KOSOVË 2020

Bazuar në Ligjin për buxhetin e Kosovës për vitin 2018, nga buxheti i Kosovës	Janë financuar 42 projekte kapitale për nivelin qendror	Vazhdim nga viti 2017 janë investuar 10,125,953.00 €	Investime të reja në vitin 2018 kanë qenë 5,337,682.00 €	Vlerësuar për vitin 2019 janë 24,850,000.00 €	Në vitin 2018 janë realizuar në total 15,463,635.00 €	Ligji Nr. 06/L-120 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 / Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 01 / 09 Janar 2018 / <a href="https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf">https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf</a>
Bazuar në Ligjin për buxhetin e Kosovës për vitin 2017, nga buxheti Kosovës	Janë financuar 37 projekte kapitale për nivelin qendror	Vazhdim nga viti 2016 janë investuar 9,744,187.00 €	Investime të reja në vitin 2017 kanë qenë 2,527,771.00 €	Vlerësuar për vitin 2018 janë 12,169,160.00 €	Në vitin 2017 janë realizuar në total 12,271,958.00 €	Ligji Nr. 05/L-125 buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 / Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 1 / 06 Janar 2017 / <a href="https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/DC67BF47-157C-4802-9837-976CBB-DE9F5B.pdf">https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/DC67BF47-157C-4802-9837-976CBB-DE9F5B.pdf</a>
Bazuar në ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2016	Janë financuar 34 projekte kapitale për nivelin qendror	Vazhdim nga viti 2015 janë investuar 4,206,558.00 €	Investime të reja në vitin 2016 kanë qenë 1,560,000.00 €	Vlerësuar për vitin 2017 janë 8,262,211.00 €	Në vitin 2016 janë realizuar në total 5,766,558.00 €	Ligji Nr. 05/L-109 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 / Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 / 3 Gusht 2016 / <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12760">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12760</a>

Bazuar në ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2015	Janë financuar 20 projekte kapitale për nivelin qendror	Vazhdim nga viti 2014 janë investuar 2,325,827.00 €	Investime të reja në vitin 2015 kanë qenë 297,940.00 €	Vlerësuar për vitin 2016 janë 3,338,999.00 €	Në vitin 2015 janë realizuar në total 2,623,767.00 €	Ligji Nr. 05/L-046 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës / Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20 / 05 Gusht 2015 /  <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10996">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10996</a>
--	---	--	---	---	---	--

Investimet në sektorin e ujërave nga donatorët për periudhën 2015-2019 kryesisht kanë qenë projekte ndërshtetërore me shtetet fqinjë, ose edhe investime në fushën e ujërave në kuadër të projekteve të përgjithshme mjedisore.

Tabela 24. Investimet nga projektet

Emri i projektit	Organizata përkrähëse-donatori	Vlera e projektit	Periudha e implementimit
Mbështetje të Zbatimit në Paketën e energjisë me fokus në Eficiencë të Energjisë dhe Energjisë së Ripërteritshme	BE & GFA	2,274,190.00 €	2016 – 2019
Projekti “Mbështetje Programit Mjedisor MMPH-së Kosovë “	SIDA	6,810,000.00 €	2016 – 2020
Projekti “Mbi menaxhimin e integruar të burimeve ujore të pellgut të zgjeruar të Drinit”	UNDP/GEF	1,000,000,00 \$	2016 – 2019
Projekti për ndërtimin e sistemit lagunar për trajtimin e ujërave të zeza në Kramovik	UNDP/GEF	200,000.00 €	2016 – 2019
Projekti Regional për vërshime “IPA FLOODS”	BE&CIMA	1,998,386.00 €	2015 - 2017

## 9. MASAT DHE PARANDALIMI I NDOTJËS SË UJËRAVE

Masat që duhet të ndërmerren për parandalimin e ndotjes së ujërave janë të shumta, por do të adresohen disa që janë më kryesore;

- Funksionalizimi dhe fuqizimi i institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e ujërave;
- Hartimi i një Plani Nacional për parandalimin e ndotjes së burimeve ujore;
- Të identifikohen të gjithë ndotësit potencial të ujërave;
- Për shkelsit e ligjit për mbrojtjen e ujërave të marren masat për parandalimin dhe penalizimin e tyre;
- Sektori privat duhet të jetë me i kujdesshëm në rruajtjen dhe mbrojtjen e ujërave nga ndotja;
- Të bëhet integrimi i sistemit për menaxhim të ujërave të ndotura;
- Të investohet në zgjerimin e mbulueshmërisë me sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura;
- Monitorimi i vazhdueshëm i ujërave të ndotura;
- Trajtimi i ujërave për arritjen e përputhshmërisë me standardet e BE-së;
- Përgatitja e një strategjie për shfrytëzimin e qëndrueshëm të inerteve nga pellgjet lumore;
- Dhënia e lejeve të shfrytëzimit të ujit për hidrocentrale vetëm në raste kur nuk e dëmton ekosistemin ujorë të lumenjve dhe respektimin e minimumit biologjik;
- Menaxhimi i ndotjes difuzive nga bujqësia;
- Regjistri i tokave të kontaminuara dhe izolimi i tyre me bariera izoluese;
- Shmangie nga cfardo lloji shkarkimi të pesticideve dhe kemikateve të rrezikshme për ujërat;
- Ndalimi i mbeturinave afër çdo burimi të ujërave;
- Shmangje të shkarkimeve të çfarëdo lloji vajrave të përdorura në sektor të ndryshëm;
- Sigurimi i digave dhe investime në përmirësimin e tyre;
- Sigurimi dhe izolimi i bazeneve akumuluese për të mos pasur qasje personat e pautorizuar etj;
- Masat për parandalimin e e zonave që kanë rrezikshmëri të lartë nga erozionet dhe vërshimet etj.

## 10. Konkluzionet dhe rekomandimet

Kosova edhe pse ka një Strategji të ujërave, ajo duhet të implementohet sipas projekteve të parapara. Përkundër progresit të arritur akoma është larg përbushjës së standardeve të BE për ujërat. Vendi ynë është në fazën e ndërtimit të infrastrukturës për furnizim me ujë të pijshëm, rrjet të kanalizimeve, trajtim të ujërave të ndotura, mbrojtje nga vërshimet, etj.

### Konkluzionet:

- Akoma kemi ngecje në implementimin e plotë të infrastrukturës ligjore për ujërat;
- Mungesa e shtrirjes së sistemit të furnizimit të popullatës me uji për pije dhe ujtitje të tokës në tërë vendin;
- Ndotja e ujërave sipërfaqësore vlerësohet të jetë ende e lartë, veçanërisht në viset urbane ku ka shkarkim të ujërave të përdorura dhe industrial;
- Mungesa e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura, konsiderohet një ndër problemet kyçe në sektorin e ujërave;
- Sistemi i monitorimit të ujërave sipërfaqësore ka nevojë për shpeshësi të monitorimit dhe modernizimit, veçanërisht monitorimi i metaleve të rënda;
- Mungon sistemi i monitorimit të ujërave nëntokësore;
- Kërkesat për shfrytëzimin e resurseve ujore janë në rritje;
- Akoma vazhdon degradimi i shtretërve të lumenjëve, sidomos përgjatë rrjedhës së Drinit të Bardhë, Lumbardhit të Pejës etj;
- Ka mungesë të hulumtimeve shkencore në fushën e ujërave e sidomos në hulumtimin e resurseve ujore nëntokësore;
- Përkundër investimeve dhe projekteve të realizuara në sektorin e ujërave, nevojat dhe kërkesat për mbështetje janë të mëdha.

### Rekomandimet:

- Plotësimi i bazës ligjore për ujëra dhe harmonizimi i saj me Direktivat e Bashkimit Evropian.
- Implementimi i infrastrukturës ligjore të ujërat në të gjitha sektoret.
- Kompletimi dhe modernizimi sistemit për monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor.
- Investime dhe kompletimi në infrastrukturën për trajtimin e ujërave urbane në gjithë vendin.
- Përmirësimi dhe modernizimi i sistemit të ujësjetësive në tërë vendin.
- Përmirësimi dhe shtrirja e rrjetit për trajtimin e ujërave urbane dhe industrial.
- Masat për parandalimin e humbjes së ujërave në rrjet.

- Përgaditja dhe implementimi i një plani për monitorimin e ujërave nëntokësore.
- Parandalohet çfardo lloji ndotjesh të ujërave në vend,
- Të ketë ngritje të bashkëpunimit dhe informimit në mes institucioneve qendrore dhe lokale.
- Realizimi i hulumtimeve shkencore në fushën e ujërave e sidomos në hulumtimin e resurseve ujore nëntokësore.
- Ngritja e edukimit në komunitet për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore.
- Ngritja e vetdijësimit në komunitetin e biznesit dhe ekonomive familjare për shfrytëzimin e qëndrueshëm të ujërave në vend.
- Vlerësimi i nevojave për investime në infrastrukturën e ujërave dhe prioritizimi i tyre.

## 11. Referencat

1. Ligji Nr. 04/I-147 për Ujërat e Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2013
2. Programi i Monitorimit të Ujërave Siperfaqësor dhe Nëntokësor 2014-2015, MMPH, datë: 26. 03.2014, Nr. SP1451/14
3. Strategjia e Ujërave të Kosovës 2017-2036
4. B. Mustafa, E. Hoxha, “Biodiversiteti dhe Zonat e Mbrojtura”, Prishtinë, 2004
5. Ligj Nr. 81/2017 për Zonat e Mbrojtura, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, 2017
6. Ligji Nr. 04/I-147 për Ujërat e Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2013
7. Udhëzimi Administrativ, Nr. 28 për Zonat e Mbrojtura Sanitare, MMPH, Republika e Kosovës, 2004
8. <https://www.eea.europa.eu/themes/biodiversity/natura-2000/the-natura-2000-protected-areas-network>
9. MMPH/AMMK – Raport për gjendjen e Ujërave në Republikën e Kosovës, Prishtinë 2015
10. Agjencioni Statistikave të Kosovës
11. ARRU-Raporti vjetor 2018
2. Agjencia e Statistikave të Kosovës 2019
13. Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
14. Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
15. Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017 – 2036
16. Raportet mjedisore mujore dhe vjetore të KEK-ut 2009-2019
17. Raportet mjedisore mujore dhe vjetore të NewCo Feronikeli 2009-2019
18. Raportet mjedisore mujore dhe vjetore të SharrCem 2009-2013
19. VMV- nga vlerat serike mujore janë llogaritur vlerat mesatare vjetore
20. Rrjeti i monitorimit të ujërave nëntokësor (Draft)-AMMK/IHMK, Prishtinë, 2019
21. Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017 – 2036
22. Statistikat e Ujërave në Kosovë 2018-2019
23. Projekt i TFU - Rishikimi i Sigurisë së Digave në Kosovë WTF Project - Dam Safety Review Kosovo, 2012

## 12. Lista e shkurtesave

- MEA** - Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
- AMMK** - Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
- IHMK** - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
- MSH** - Ministria e Shëndetësisë
- IKSHP** - Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
- ARPL** - Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore
- ARRU** - Autoriteti Rregullativ i Ujërave
- ZRRUM** - Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina
- KRU** - Kompanitë Regjionale të Ujërave
- KEK** - Korporata Energjetike e Kosovës
- BE** - Bashkimi Europian
- AEM** - Agjencia e Mjedisit të Evropës
- OBSh** - Organizata Botërore e Shëndetësisë
- DKU**- Direktiva Kornizë e Ujërave
- SIU**- Sistemi Informativ i Ujërave
- GIS**- Sistemi Gjeografik i Infomatave
- SPI**- Indeksi Standard i Reshjeve

## 13. Lista e tabelave

**Tabela 1.** Sasia totale e reshjeve për periudhen 2015-2020

**Table 2.** Burimet ujore si zona të mbrojtura

**Tabela 3.** NënPELLGJET ujore

**Tabela 4.** Të dhënat themelore për lumenjtë dhe PELLGJET ujore

**Tabela 5.** Akumulacionet sipërfaqësore në territorin e Kosovës

**Tabela 6.** Akumulimet nëntokësore ujore në Pellgun e Drinit të Bardhë, sipërfaqja, vëllimi dhe kapacitetit i tyre

**Tabela 7.** Karakteristikat fiziko-kimike të disa burimeve termominerale

**Tab. 8.** Kompanitë e licencuara për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura (Ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit)

**Tabela 9.** Furnizimi i ekonomive familjare më ujë të pijshëm në Kosovë 2015-2019

**Tabela 10.** Hidrocentralet aktive në Kosovë

**Tabela 11.** Hidrocentralet në fazën e ndërtimit

**Tabela 12.** Objektet të destinuara për rekreacion

**Tabela 13:** Norma (%) e testeve bakteriologjike dhe fiziko-kimike në përputhje me standardet e cilësisë së ujit sipas KRU-2018/2019

**Tabela 14.** Ujërat urbane të shkarkuara për vitet 2015-2018

**Tabela 15.** Parashikimet për investimet për trajtimin e ujërave urbane

**Tabela 16.** Ujërat e shkarkuara industria dhe operatorët ekonomik për vitet 2015-2018

**Tabela 17.** Trajtimi i ujërave urbane në Impaintin në Skenderaj, vitet 2015-2019

**Tabela 18:** Paralajmrimet zyrtare të përmbytjeve në Kosovë në vitin 2016.

**Tabela 19.** Digat në Kosovë

**Tabela 20.** Sipërfaqet e shtretërve të lumenjve të degraduara për vitin 2009-2018

**Tabela 21.** Ujërat e pa trajtuara të cilat merren drejtëpërdrejtë

**Tabela 22.** Aktivitetet për leje dhënie në fushën e ujërave

**Tabela 23.** Investimet nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës

**Tabela 24.** Investimet nga projektet



## 14. Lista e figurave

- Figura 1.** Harta gjeologjike e pellgut Drini i Bardhë
- Figura 2.** Harta hidrogeologjike e pellgut Drini i Bardhë
- Figura 3.** Harta gjeologjike e pellgut lumor Ibër-Sitnica
- Figura 4.** Harta hidrogeologjike e pellgut lumor Ibër-Sitnica
- Figura 5.** Harta gjeologjike e pellgut lumor Morava e Binçës
- Figura 6.** Harta gjeologjike e pellgut lumor Morava e Binçës
- Figura 7.** Harta gjeologjike e pellgut lumor Lepenc
- Figura 8.** Harta hidrogeologjike e pellgut lumor Lepenc
- Figura 9.** Harta e pellgjeve lumore të Kosovës
- Figura 10.** Harta e nënpellgjeve lumore të Kosovës
- Figura 11.** Harta e pellgjeve lumore
- Figura 12.** Harta e rjetit hidrografik dhe akumulimet sipërfaqësore të Kosovës
- Figura 13.** Harta e akumulacioneve ekzistuese dhe planifikuese
- Figura 14.** Burimi termomineral ne Banjë të Pejës
- Figura 15.** Burimet ujore termo-minerale
- Figura 16.** Foto-Ligatina e Hencit/F.Bajraktari
- Figura 17.** Sasia e ujit të shpenzuar për ujitje 2001-2019
- Figura 18.** Sipërfaqet e ujitura 2001-2019
- Figura 19.** Sasia e ujit të shpenzuar nga KEK-u gjatë procesit të prodhimit të energjisë 2009-2019
- Figura 20.** Sasia e ujit të shpenzuar në New Co Feronikel, 2009-2019
- Figura 21.** Sasia e ujit të shpenzuar në Sharrcem, 2009-2019
- Figura 22:** Stacionet e monitorimit të cilësisë së ujërave të lumenjëve
- Figura 23:** Oksigjeni i tretur në pellgun e Drinit të Bardhë mg/l
- Figura 24:** Shpenzimi biokimik i oksigjenit në pellgun e Drinit të Bardhë mg/l
- Figura 25:** Përçueshmëria elektrike në pellgun e Drinit të Bardhë
- Figura 26:** Përqendrimi i jonit hidrogjen në pellgun e Drinit të Bardhë
- Figura 27:** Azoti i nitrateve në pellgun e Drinit të Bardhë
- Figura 28:** Azoti i nitriteve në pellgun e Drinit të Bardhë mg/l
- Figura 29:** Azoti i amoniumit në pellgun e Drinit të Bardhë mg/l
- Figura 30:** Fosfori i ortofosfateve në pellgun e Drinit të Bardhë mg/l
- Figura 31:** Fosfori total (poli dhe orto) në pellgun e Drinit të Bardhë mg/l
- Figura 32:** Oksigjenit të tretur në pellgun e Ibrit mg/l
- Figura 33:** Shpenzimi biokimik i oksigjenit në pellgun e Ibrit mg/l

- Figura 34:** Përçueshmëria elektrike në pellgun e Ibrit
- Figura 35:** Përqendrimi i jonit hidrogjen në pellgun e Ibrit
- Figura 36:** Azoti i nitrateve në pellgun e Ibrit mg/l
- Figura 37:** Azoti i nitriteve në pellgun e Ibrit mg/l
- Figura 38:** Azoti i amoniakut në pellgun e Ibrit mg/l
- Figura 39:** Fosfori i ortofosfateve në pellgun e Ibrit mg/l
- Figura 40:** Fosfori total (poli dhe orto) në pellgun e Ibrit mg/l
- Figura 41:** Oksigjenit të tretur (mg/l) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës
- Figura 42:** Shpenzimi biokimik i oksigjenit (mg/l) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës
- Figura 43:** Përçueshmëria elektrike ( $\mu\text{s}/\text{cm}$ ) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës
- Figura 44:** Përqendrimi i jonit hidrogjen (pH) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës
- Figura 45:** Azoti i nitrateve (mg/l) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës
- Figura 46:** Azoti i nitriteve (mg/l-) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës
- Figura 47:** Azoti i amoniumit (mg/l) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës
- Figura 48:** Fosfori i ortofosfateve (mg/l) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës
- Figura 49:** Fosfori total (poli dhe orto) (mg/l) në pellgun e Lepencit dhe M. Binçës
- Figura 50:** Harta e rrjetit hidrografik dhe pusët monitoruese
- Figura 51:** Perputhshmëria e testeve për uji të pijes sipas standardeve vendore për parametrat bakteriologjike dhe kimike (KRU-te, 2018/2019)
- Figura 52:** Impianti për trajtimin e ujërave në Skenderaj
- Figura 53:** Zone e përmbytur nga lumi Sitnica afër Nadakocit me 10 Nëntor 2016.
- Figura 54:** Disperzioni i përfshirjes së thatësisë
- Figura 55:** Foto nga vërshimet
- Figura 56:** Te reshurat sipas Indeksi i standardeve të reshjeve
- Figura 57:** Thatësira në Liqenin e Badovcit
- Figura 58:** Degradimi i Lumit Drini i Bardhë, 2012-2018

**Raportin e përgatiten:**

Tafe Veselaj PhD - Kryesues  
Merita Mehmeti Msc- Anëtare  
Agron Shala Msc. - Anëtarë  
Përparim Gashi Msc.- Anëtarë  
Fatlije Buza - Anëtare  
Osman Fetoshi Msc.- Anëtarë  
Fidan Bilalli - Anëtarë  
Selvije Raci - Anëtare  
Hasan Hasani – Anëtarë

**Në hartimin e raportit kontribuan edhe:**

Afrim Berisha PhD, DVGJM/AMMK  
Filloreta Berisha, DVGJM/AMMK



PHOTO: MILOT KURSHUMLIU ©

